



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-11539/24
Kaçanik, 17.05.2024

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e V (pestë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 27.05.2024 (e Hënë), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e V (pestë) të Rregullt të KPF-s të datës 27.05.2024, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Draft Statuti i Muzeut të qytetit të Kaçanikut;
3. Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2024;
5. Propozim Vendimi për shkëputjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Mevlud Zharku;
6. Propozim Vendimi për shkëputjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “KAÇINKA” L.L.C.
7. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga burimi i fondeve 22 - të hyrat e bartura nga viti kaluar 2023 ne buxhetin e vitit 2024.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-9167/24
Kaçanik, 25.04.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 25.04 2024 Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF fillimisht ishin 7 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi, gjatë pikës së dytë arriti, Fitore Vishi, kështu që pjesëmarrje në këtë mbledhje nga kjo pikë ishin 7 anëtarë-të gjithë.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, ndërkaq nga zyrtarët, Mavije Murseli.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu- ZLP për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të KPF-a për vitin 2024, data 25.04.2024, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2024;
3. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec;
4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite;
5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të “Dream Palace” SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 5 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar u aprovua njëzëri, pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së III (tretë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 25.03.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-6693/24.

2. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është prezentë në mbledhje, lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Pyetje për drejtorin: Pse nuk është marrë për bazë buxheti final, por buxheti i miratuar, ndërkaq shqetësuese janë shpenzimet e vogla të Investimet kapitale, 2.6% e mjeteve të shpenzuara. Ndërkaq janë shpenzuar 27, 222,75€ të mallrat dhe shërbimet për vendime të gjykatave si dhe kemi shpenzime për shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse.

z. Bahri Selimi: Tani jemi në periudhën TM2, ndërkaq Raporti ka të bëjë me periudhën, janar-mars 2024, ashtu që buxheti në këtë fazë është i njëjtë me buxhetin e miratuar, se ende nuk është bërë bartja e të hyrave, ku rritet buxheti, për këtë arsye shpenzimet janë bërë në raport me buxhetin e miratuar. Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit janë 16.97%. Buxheti i miratuar është 11,958,983€, është prezantuar në faqen 1, e shihni se buxheti i miratuar me atë të tanishëm është i njëjtë. Kur të hyjmë në periudhën e katër mujore, buxheti ndryshon, me bartjen e të hyrave apo me ndonjë tejkalim shtesë të hyrave.

z. Agim Mani: Gjithsesi është dashur me qenë buxheti aktual, se jemi hyrë në vitin 2024, e jo buxheti i miratuar qysh e keni prezantuar, se është çështja e bartjes se mjeteve mbi 1 milion euro.

z. Bahri Selimi: Buxheti i miratuar nuk ka asnjë ndryshim, mjetet e bartura janë bërë para një jave, këto do të paraqitën në TM2, se bartja ka ndodhë në muajin prill, ndërsa raporti është janar-mars 2024. Investimet kapitale janë të ulëta në këtë periudhë, vetëm obligimet që ka komuna në këtë periudhë që kemi kryer, ndërkaq nuk kemi bërë investime kapitale.

z. Agim Mani: A ka pasur ndonjë projekt 2 vjeçar që është dashur me u realizuar?

z. Bahri Selimi: Po kemi pasur, por nëse krahasojmë këtë periudhë me vitin e kaluar, na del mbi 7,000€ shpenzime me tepër, por nuk kemi realizuar diçka me shumë.

z. Agim Mani: Nëse keni pasur projekte kapitale, shpenzimet kapitale ka pasur mundësi me shënuar ngritje.

z. Bahri Selimi: Sqaroj për projekt kapitale dhe shumat e shpenzimeve të realizuara: Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike, Zhvillimi ekonomik, Ndërtimi i parqeve në Strazhë. Shpenzimet e gjykatave, sqaroj për shpenzimet e paguara diku shuma me e madhe është 15,000 € që janë nga shërbimet publike, ku kemi pasur një procedurë përmbarimore prej një operatori ekonomik, ndërkaq sqaroj edhe për shpenzimet tjera përmbarimore në shuma të caktuara, personave që janë paguar, përmendi edhe përmbaruesit privat.

z. Agim Mani: Është mirë me ditur për cilin operator është fjala?

z. Bahri Selimi: Po, e kemi përmbarues privat Sh. Livoreka, shpenzimet janë për B. Tasholli, ndërkaq nga administrata, 7,000 €, A. Vlashi SHPK, i njëjti edhe të shëndetësia 1699 € për do paga jubilarë. Shërbimet intelektuale, janë të Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Fitorja paska ardhur tani në mbledhje, kjo është në këtë komitet. Shërbimet në këtë komitet janë për shërbime këshillëdhënëse. Shumicën e shpenzimeve na i kanë ngritur shpenzimet për administratorë të fshatrave, janë kryer shpenzime të vitit të kaluar që kanë qenë obligime të pa paguara, shuma 529 € pagesa për 3 muaj, një mbledhje 176 €, i kanë mbajtur 5 mbledhje, iu kanë paguar 3 mbledhje. Obligimet e papaguara i kemi paraqitur në raport financiar. Kryetari kur e bënë

buxhetin për vitin e ardhshëm, normal se konsultohet me administratorët e fshatrave për orientimet buxhetore, se për çka ka nevojë me tepër komuniteti.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor në këtë buxhet nuk figuron, bartja e mjeteve nga viti i kaluar. Bartja me nuk bëhet me KK, por qysh ndodhë?

z. Bahri Selimi: Bartja e mjeteve nuk bëhet me më KK, ndërkaq shpërndarja e tyre bëhet me KK. Ato mjete kthehen në kode buxhetore dhe ne i shikojmë se ku janë të nevojshme me i orientuar, janë diku 230,000€ që bartën.

Kryesuesi i Kuvendit: Dallimi nga hera tjera, është se me herët bartja e mjeteve është bërë me vendim të KK, tani është një formë me ligj, ku bartja e tyre bëhet në ato kode buxhetore nga kanë mbetur mjetet.

z. Bahri Selimi: Ka pasur mjete në kode buxhetore ku nuk janë shpenzuar asnjë, ato mjete duhet me i hequr nga kodet buxhetore.

z. Ardita Rrahmani: Pse po ndodhë që me mbetur mjete të pashpenzuara dhe a hynë këto mjete që kanë ngelur në rishikim të buxhetit?

z. Bahri Selimi: Me herët mjetet të cilat ngelnin e hartonim Propozim Vendimin se ku me i orientuar. Tani ministria me ligjin e buxhetit e ka paraparë që komunave iu barten mjetet aty ku kanë mbetur, dhe ato mjete tani kemi të drejtë me i transferuar diku tjetër, p.sh. në mallra dhe shërbime, me vonë me i ri destinuar.

z. Ardita Rrahmani: Për neve është e paqartë që mjetet të bartën në kodin e projektit të përfunduar.

z. Qamil Stagova: Fjala vjen, ne e kemi zotuar një shumë të mjeteve të projekti i nënkalimi për këmbësor, ai projekt nuk është kryer, tani në këso raste kur është projekti, ministria i bartë mjetet në atë projekt.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky raport t'i shkoj KK në shqyrtim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se, **KPF shqyrtoj Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2024 dhe i njëjti i kalon Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.**

3. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Është mirë që komisioni i cili punon në këtë drejtim, fillimisht me u ndërruar, se nuk po e kryen punën si duhet. Duhet pasur kujdes të ndërrimi i destinimit të klasës 1-4 se po e dëmtojmë tokën bujqësore. Këtu kemi të bëjmë me një sipërfaqe bukur të madhe që propozohet me iu ndërruar destinimi nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Është mirë fillimisht t'i shikojmë kërkesat e qytetarëve, të shikojmë qëllimin, cili është interesi i qytetarit dhe cili është interesi i komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Komisioni është profesional, formohet nga drejtorja, ndërkaq me shikuar interesin e komunës, duhet me i kryer këto punë menjëherë, por çështja është se nuk po e kemi fuqinë, ndërkaq komuna po zbrazet. Çfarë karakteri bujqësor ka ajo tokë midis shtëpive? E keqja është se ne kemi stagnuar sa i përket aspektit të ndërtimit. Në këtë rast i ka fajet edhe ekzekutivi që po e shikojnë në detaje këto punë, se duhet me ecur përpara, se ne nuk iu kemi ofruar asnjë mundësi qytetarëve këtu për banim. Tani me numër të regjistrimit të popullsisë kemi me pa sa banorë i ka Kaçaniku.

znj. Ardita Rrahmani: Sa është numri i banorëve të regjistruar deri tani?

Kryesuesi i Kuvendit: Regjistrimi i popullsisë është ende në proces. Sido që të jetë, në këto çështje, ne të gjithë se bashku duhet pasur mirëkuptim. Duhet me u angazhuar me shtyrë përpara këtë proces, se është duke na penguar tepër shumë. Për mendimin tim, asnjë mënyrë e banimit kolektiv nuk ka me tepër pengesa sesa kjo, por mirë është që këto çështje me tentuar me i shtyrë përpara. E dimë se ekziston mundësia me na i kthyer ministria, por të paktën ne të tentojmë t'i shtyjme përpara këto procese, se kemi ngecur si pasojë i një PZHK që sa vite. Është një problem që e dimë të gjithë, Kaçaniku nuk ka vend për tokë ndërtimore dhe shumë familje janë shpërngulur kohëve të fundit për këto arsye. Në këto çështje duhet me qenë të gjithë bashkë, se është interes jo vetëm i yni si komunë, por i gjithë shtetit, se nesër kemi me pas anëtarë me pak të KK, buxhet me pak. Me tregoni cili është interesi i komunës në këtë rast, me i ruajtur 50 ari tokë bujqësore?

z. Agim Mani: Unë e kam qëllimin me kryer ndërrimin e destinimit, ju e keni qëllimin mos me kryer. Nuk është mirë ju kryesues me marrë barrën e ekzekutivit. Ne kemi raste, si çështja e BK, është ndërtuar, ndërkaq problemet janë tani. E kemi banesën e ndërtimit social, është ndërtuar, cila është gjendja e banesës tani?

z. Qamil Stagova: Çështja e pronave në qendër të qytetit, është tjetër, nuk kanë të bëjnë me ato pronat.

Kryesuesi i Kuvendit: Projekti i BK është i legalizuar, jemi duke folur për pronat tjera, që me iu bërë njerëzve zgjidhje të banimit.

z. Agim Mani: Ligji i specifikon çështjet sesi me vepruar.

znj. Ardita Rrahmani: Para nja dy muajve kemi marrë një vendim të kësaj natyre dhe nuk është kthyer përgjigje. Në çdo mbledhje po diskutojmë çështje të ndërrimit të destinimit të pronave dhe çështjet po kalojnë në KK, pavarësisht kush po i voton. E kam një pyetje: Në momentin që nuk kthehet përgjigje prej ministrisë, a i epet e drejta personit në fjalë me vazhduar me punimet? Me çfarë të drejte fjala është më vjen mua një vendim për gjykatë, kur unë nuk e kam një përgjigje prej ministrisë? Pala po dëmtohet edhe në kohë për mos përgjigje dhe me mjete financiare, për fajin e ministrisë që nuk ka kthyer përgjigje. Ne si komunë çka mundem me bërë në këto raste?

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket vendimeve që merren në KK, Ligji për vetëqeverisje lokale thotë se janë 7 ditë për me i hartuar vendimet dhe me i dërguar në MAPL. Ne i dërgojmë të gjitha vendimet, se ka vendime që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshme të ligjshmërisë. Ndërkaq 15 ditë është afati ligjor për ministrinë për vlerësimin e ligjshmërisë a është vendimi apo jo në harmoni me ligjin. Pas 15 ditëve, ne iu shkruajmë edhe 1 herë apo 2 herë nga zyrtari i KK, se afati ligjor ka kaluar dhe planifikojmë publikimin e vendimeve. Ka raste kur na thonë me prituri ndonjë ditë, por ka raste kur heshtin. Ne i publikojmë vendimet, ndërkaq sipas LVL vendimet hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit të tyre. Për atë vendim, askush nuk mundet me të kontestuar, ndërkaq për punimet, a zhvillohen në harmoni me ligjin, ajo është diçka tjetër. Unë kam qenë deri në gjykatë të apelit për vendimin e ndarjes së masës drusore. Ne e respektojmë afatin ligjor, ndërkaq nëse ministria heshtë, ajo është çështje tjetër. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni kjo çështje të shkoj në procedurë të KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe kjo çështje është gati e njëjtë me pikën paraprake. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Unë nuk e thashë rastësisht që kërkova që komisioni vlerësues me u shkarkua, se po bënë gabime të ndryshme. Komisioni nuk e ka kryer punën si duhet. Komisioni duhet me u bazuar në kërkesën e qytetarit dhe me dalë në vendngjarje, me konstatuar gjendjen reale faktike se a është në harmoni me PZHK dhe ligjet në fuqi. Kjo pronë thuhet se është në qira mbajtje për 99 vite. A është privatizuar kjo pronë apo është dhënë në shfrytëzim për 99 vite?

Kryesuesi i Kuvendit: Sa e di unë, kjo pronë është privatizuar prej AKP.

z. Agim Mani: Në Propozim Vendim thuhet se, sipas PZHK, kjo hapësirë është e paraparë për tokë bujqësore. Nëse i ndërrohet destinimi, kjo bien në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-174 e Planifikimit hapësinor, që e përcakton se ndërrimi i destinimit duhet me u bazuar në PZHK.

Kryesuesi i Kuvendit: Arsye ka, se me qenë me PZHK, këto ndërrim destinime nuk kanë nevojë me ardhur këtu. Lejohet ndërhyrja në PZHK, por nuk po e lejojnë. PZHK e ka miratuar KK, ne duhet me iu dhënë shtytje këtyre çështjeve, në mungesë të PZHK, se çdo pritje na kushton. Nëse na kalojnë në ministri, është mirë, por nëse nuk na kalojnë, mos të na ngelë faji ne. A e dini se cilat janë kriteret për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?

Kryetari i Komunës: Në mungesë të PZHK dhe arsyesh mërisë, lejohet ndërhyrja në PZHK, por nuk po e lejojnë.

z. Agim Mani: Unë kisha thënë që kjo çështje mos të shkoj fare në KK, por t'i kthehet propozuesit në rishqyrtim.

Kryetari i Komunës: Me shikuar qysh janë bërë ndërtimet në disa komuna tjera, janë bërë me plane rregulluese. Ishte një Udhëzimi administrativ për bonuse. Ti i jep tokë, dhe ti e lejon 2 kate me lartë. Ne asnjë centimetër nuk e kemi shtuar, dhe kur jam marrë në pyetje, iu kam treguar se nuk kam lëvizë në asnjërin anë me objektin, vetëm janë shtuar 2 kate lartë, por çështja me tha është se, na kanë sjellë këtë lëndë dhe duhet me u marrë me këtë. Njerëzit kanë interes me investuar, por për shkak të kësaj situate kemi ngelë peng i zhvillimit, se njerëzit i dërgojnë lëndët në gjykatë. Qysh jeni duke thënë ju Agim është, por çështja është se me është dukur investimi me interes të komunës, sikurse që ka pasur interes autostrada që nuk na kanë pyetur fare. Edhe pala po pajohet me u zhvilluar procedura, ishte një vajzë nga Deçani, dhe ia sqarova se ligji nuk e lejon ndërtimin e destinimit, për shkak se nuk është me PZHK. Ajo me tha: pavarësisht a e kthen ministria apo jo, të trajtohet kjo çështje në organet e komunës, pastaj unë merrem me atë punë.

z. Agim Mani: Nuk e di sa isha i qartë, investimi për komunën tonë është shumë i lartë, por jeni duke e penguar këtë çështje, se ky Propozim Vendim në këtë formë nuk kalon, se komisioni duhet me kryer punën si duhet. Nëse e ktheni këtë lëndë komisionit, unë ju tregoj sesi me vepruar.

Kryesuesi i Kuvendit: A po e shihni si po zhvillohen vendet tjera, edhe zonat malore, si Jezerci dhe nuk ka shkuar shumë kohë dhe nuk kemi me pasur interesim me ndërtuar dhe me zhvilluar vendin në komunën tonë. Edhe ato të cilat i kanë ndërtua (në Strazhë) janë duke i shitur.

z. Qamil Stagova: Kjo kërkesë ka të bëjë me investime në panele solare, kjo përputhet edhe me planin e qeverisë për prodhimin e energjisë. Besoj se kjo ka me kaluar në qeveri, është fjala për një sipërfaqe të madhe të tokës bujqësore.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që të shkoj në KK kjo çështje? Për votuan 5 anëtarë, Kundër ishin 2 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të “Dream Palace” SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi;

E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Me çka e dëshmoni se kjo pronë është e këtij personi?

z. Qamil Stagova: E dëshmoj me Certifikatën e pronës, në emër të “Dream Palace” SH.P.K. nga Ferizaj.

z. Agim Mani: Kjo parcelë thuhet se është pronë shoqërore.

z. Qamil Stagova: Çështjen e pronave në qytet e kemi shpjeguar disa herë Agim.

Kryetari i Komunës: Për këtë çështje jam angazhuar 1 vit, e kam ngritur këtë temë vjet. Është një vendim i viteve të 80-ta që këto prona i evidenton në shoqërore. Me tryshinë që kemi bërë ne, sivjet janë lejuar, dhe këta paguajnë tatim në pronë. Edhe pagesa e tatimit në pronë është e kundërligjshme, por kjo qeveri e ka lejuar. Ata janë pronarë të pronave që 500 vjet, por për shkak të vendimit të viteve të 80 –ta, po kanë probleme, se me atë vendim e kanë lënë të gatshme në pronë shoqërore, me u zgjeruar të ardhmen qyteti.

z. Agim Mani: Unë po e shoh që është pronë shoqërore. A mundeni me marrë autorizim për këto prona.

z. Qamil Stagova: Nuk është pronë shoqërore, këto prona kanë tjetër status.

Kryesuesi i Kuvendit: Prej kujt me marrë autorizim, autorizimin e jep komuna. Fleta poseduese, kopja e planit janë në emër të personit. Shkruan edhe prejardhja e pronës prej kujt e ka blerë. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë çështje dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të “Dream Palace” SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi. Ky propozim vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:52. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët-07. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 29.04.2024, në ora 11:00.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT • OPSTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK



Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

LISTË DISTRIBUIMI/CIRKULARNO PISMO/ROUTING SLIP

REFERENCË	09-106/02-11431/24
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin e Kuvendit, Kemal Murseli
Kopje:	
NGA/OD/FROM	Drejtoresha për Kulturë, Rini e Sport, Hafize Sallahu <i>Hafize</i>
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft Statuti i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut
DATË/E	16.05.2024

I nderuar,

Pas hartimit të Draft Statuti i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut nga Këshilli Punues i emëruar me vendim të Kuvendit Komunal dhe pas kalimit të këtij Drafti në të gjitha procedurat, kët dokument ua përcjellim për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës .

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT • OPSTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK



Bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2 (pika d) dhe nenin 17, (pika r) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 6 paragrafi 1 të Statutit të komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas statutit 01Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.3588/2008 të datës 25.09.2008), nenit 12, paragrafit 12.2. dhe 12.5 dhe Neni 14 të Ligjit Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut , në mbledhjen e mbajtur me datën, miraton:

DRAFT STATUTI I MUZEUT TË QYTETIT TË KAÇANIKUT

Maj 2024

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Statut përcaktohen dhe rregullohet mandati, veprimtaria, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, historiku, themelimi, funksionimi, statusi juridik, emërtimi, selia, vula dhe shenja dalluese (logo), pozita juridike, organizimi i brendshëm dhe administrimi, burimet e financimit dhe projektet, përfaqësimi, përzgjedhja dhe organizimi i punonjësve profesional, administrativ dhe teknik, bashkëpunëtorëve të jashtëm si dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese për dhe rreth Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

Neni 2

Historiku i Muzeut

Muzeu i Qytetit të Kaçanikut është institucioni i parë i këtij lloji në Komunën e Kaçanikut, i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me Nr. 01 Nr.09-60/01-25460/22 të datës 29.09.2022 me qëllim të arkivimit, selektimit, ruajtjes dhe promovimit të relikteve, dokumenteve si dhe gjësendeve tjera të trashëgimisë së luajtshme kulturore me peshë historike individuale dhe shoqërore, duke filluar që nga periudha parahistorike, periudhat historike në vijim, përfshirë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e deri më sot.

Neni 3

Statusi

1. Kompetencat, mandati, detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe organizimi dhe funksionimi i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut rregullohet me Ligjin Nr. 02/L - 057 për Institucionet e Kulturës, Ligjin Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, këtë Statut dhe aktet nënligjore përkatëse.
2. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut është institucion kulturor, lokal, publik, kërkimor - shkencor, arkivor i pavarur nga partitë e grupimet politike, institucionet

apo organizatat fetare, i cili menaxhohet nga Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

3. Muzeu ka status të personit juridik publik dhe në kuadër të përcaktimit të statusit të Organeve të Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore dhe Rregullores përkatëse për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, ka statusin e organit lokal të administratës, në vartësi të Komunës së Kaçanikut, përkatësisht Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 4

Emërtimi, selia, vula dhe logo

1. Emërtimi i institucionit është Muzeu i Qytetit të Kaçanikut.
2. Akronimi i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut është MQK.
3. MQK- ja ka selinë në Bulevardin "Ismajl Raka" nr. 200, objekti i Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj", në Kaçanik.
4. MQK- ja ka logon, vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore.
 - 4.1. Vula e rrumbullakët përmban këto të dhëna: në rrethin e parë shkruhet Republika e Kosovës-Komuna e Kaçanikut, në rrethin e dytë shkruhet: Muzeu i Qytetit të Kaçanikut, në mes horizontalisht shkruhet akronimi MQK.
 - 4.2. Vula katrore përmban këto të dhëna: në rreshtin e parë shkruhet: Republika e Kosovës-Komuna e Kaçanikut, në rreshtin e dytë shkruhet: Muzeu i Qytetit të Kaçanikut, në rreshtin e tretë shkruhet: Njësia, numri i protokollit, viti, data.
5. Logo e MQK-së (përshkrimi i logos): Emri i institucionit: "Muzeu i Qytetit të Kaçanikut", kurse për paraqitjen grafike të logos (simbolin) do të zhvillohet konkurs publik i shpallur nga organet drejtuese të institucionit.

Neni 5

Veprimtaria dhe detyrat e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut

1. Veprimtaria e MQK-së është e rëndësishme së veçantë të interesit publik dhe shtrihet në gjithë territorin e Komunës së Kaçanikut.

2. MQK-ja veprimtarinë muzeore, detyrat dhe kompetencat e tij i përcakton me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme normative.

3. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, MQK-ja është përgjegjës për kryerjen e detyrave si më poshtë:

Zbaton politikat dhe strategjitë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe siguron zbatimin e legjislacionit në fushën e trashëgimisë kulturore të luajtshme, përmes realizimit me standarde shkencore dhe profesionale të hulumtimit, mbledhjes, inventarizimit, studimit, mbrojtjes dhe ruajtjes, konservimit dhe restaurimit, ekspozimit dhe promovimit të objekteve potenciale me vlera të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale, veçanërisht arkivimin, seleksionimin, promovimin, ruajtjen dhe konservimin e materialeve arkivore, dokumenteve, fotografive, video-incizimeve, gjësendet e të gjitha periudhave historike, përfshirë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e deri më sot.

3.1. Inkurajon dialogun apo debatet me komunitetin e profesionistëve, si dhe qytetarëve, përmes zhvillimit të komponentëve të edukimit, kërkimeve dhe botimeve të bazuara mbi studimin e materialeve muzeore;

3.2. Siguron mbledhjen, ruajtjen, konservimin/restaurimin dhe studimin e provave materiale dhe jomateriale të trashëgimisë historike dhe kulturore e të gjitha periudhave historike, të cilat i ekspozon dhe i paraqet në hapësira apo platforma të ndryshme dhe adekuate që nxisin kureshtjen, debatin dhe edukimin.;

3.2.1. Një material i luajtshëm, i cili me arsye mendohet se përfaqëson një m

Neni 6

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar

1. MQK-ja bazuar në Ligjin Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, Ligjin Nr.02/L-057 për Institucionet e Kulturës, këtë Statut dhe aktet tjera nënligjore në fuqi zhvillon bashkëpunim dhe bashkëveprim institucional me organet e tjera të administratës shtetërore qendrore, rajonale dhe lokale si dhe muzetë rajonale, muzetë tipologjike, muzetë lokale, muzetë private, koleksionuesit, pronarët, poseduesit dhe shfrytëzuesit eventual të objekteve potenciale muzeore në cilësi të personave fizik, për të tërhequr nga fondet e tyre apo për përdorim të përkohshëm të objekteve, me qëllim të ekspozimit të tyre në ekspozita e aktivitete të tjera të përbashkëta, apo edhe për qëllime të studimit dhe hulumtimit.

2. MQK-ja mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me ente, subjekte private apo shtetërore të huaja, në formën e binjakëzimit të parapara sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim të realizimit të projekteve të financimit, ekspozimit, zhvillimit të aktiviteteteve kulturore, promovuese.

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I MUZEUT TË QYTETIT TË KAÇANIKUT

Neni 7

Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të MQK-së janë:

1.1. Këshilli Drejtues;

1.2. Drejtori.

Neni 8

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues i MQK-së përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve me mandat katërvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

2. Këshilli Drejtues i MQK-së emërohet dhe shkarkohet nga Kuvendi Komunal.

3 Përbërja e Këshillit Drejtues të MQK-së është si vijon:

3.1 Dy anëtarë nga Organizatat e dalura nga Lufta e UÇK-së në Kaçanik;

3.2 Tre anëtarë nga komuniteti shkencor-profesional;

3.3 Një përfaqësues nga Shoqëria Civile;

3.4 Një përfaqësues nga Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

4. Njëri prej shtatë (7) anëtarëve duhet të jetë përfaqësues i Komunës së Kaçanikut, përkatësisht Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pa të drejtë që të zgjedhet kryetar i Këshillit.

5. Punën e Këshillit Drejtues e udhëheq kryetari i KD-së, i cili zgjidhet me shumicë votash nga anëtarët e Këshillit.

6. Mbledhjet e thërret dhe i udhëheq kryetari i Këshillit. Mbledhjen e parë të Këshillit e thërret dhe e udhëheq anëtari më i moshuar i Këshillit.
7. Anëtarët e Këshillit Drejtues për punën e tyre kompensohen financiarisht.
8. Anëtarët/et e Këshillit Drejtues të MQK-së kompensohen në shumë prej 100.00 € (njëqind euro) për secilën mbledhje të mbajtur gjatë vitit, përkatësisht për 12 mbledhje brenda një viti kalendarik. Pagesa do të bëhet me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës. Dëshmi për pagesë do të jetë lista e pjesëmarrjes për mbledhjen e mbajtur të Këshillit Drejtues.

Neni 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

1. Harton Statutin e MQK-së të cilin i miraton Kuvendi i Komunës.
2. Harton aktet të ndryshme normative të MQK-së.
3. Harton dhe aprovon politikat afatgjata zhvillimore të MQK-së.
4. Aprovon programin vjetor të punës dhe buxhetin vjetor të MQK-së si dhe ka qasje në dokumentacionin e rregullt dhe llogari mbajtjes.
5. Këshilli Drejtues mund të kërkojë që së paku një herë në vit, dhe në raste të veçanta, që llogaridhënia e muzeut të mbikëqyret nga nje auditor i pavarur.
6. Këshilli Drejtues bën vlerësimin e punës së drejtorit dhe të MQK-së në përgjithësi dhe për këtë i raporton Kuvendit të Komunës.
7. Këshilli monitoron, mbikëqyr dhe përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit, si edhe proceset e mundshme të ri konceptimit tërësor, apo pjesor të pavijoneve të ekspozitave, duke nxjerrë rekomandime.
8. Këshilli Drejtues propozon te themeluesi ndërrimin apo zgjerimin e veprimtarisë së MQK-së.
9. Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
10. Harton rregulloret e nevojshme për funksionimin e MQK-së, nëse nuk është rregulluar ndryshe me ligj apo akt të veçantë nënligjor.
11. Harton dhe miraton rregulloren e punës.

Neni 10

Drejtori i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut

1. Drejtori është udhëheqës dhe organi më i lartë ekzekutiv i MQK-së.
 - 1.1. Drejtori zgjidhet me konkurs publik të shpallur nga Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

- 1.2. Drejtori duhet të ketë diplomë universitare në njërin nga fushat si ajo e historisë, arkeologjisë, etnologjisë, muzeologjisë, politikave publike të trashëgimisë kulturore.
- 1.3. Mandati i drejtorit të MQK-së është katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut

1. Drejtori organizon, koordinon dhe udhëheq veprimtarinë dhe funksionimin e MQK-së, i propozon dhe i raporton Këshillit Drejtues planin e punës dhe planin vjetor financiar.
2. Merr pjesë kur ftohet në mbledhjet e Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote.
3. Përfaqëson MQK-në brenda dhe jashtë shtetit.
4. Kërkon, aplikon dhe negocion marrjen e donacioneve dhe përgjigjet për to.
5. Mbikëqyr të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe donacionet.
6. Negocion dhe nënshkruan marrëveshjet për bashkëpunim.
7. Menaxhon bashkëpunimin muzeor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
8. Informon me shkrim Këshillin Drejtues për punën gjashtëmujore të MQK-së.
9. Harton me shkrim raportin e aktiviteteve dhe raportin financiar dy herë në vit dhe informon dhe raporton në Këshillin Drejtues.
10. Ushtron detyra dhe përgjegjësi tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.
11. Ekzekuton vendimet e Këshillit Drejtues të MQK-së.
12. Përgjigjet për menaxhimin e financave dhe asetëve të MQK-së.
13. Propozon rregulloret e punës të cilat i aprovon Këshilli Drejtues dhe organi më i lartë në hierarki.
14. Obligohet të respektojë dokumentet e pranuar ndërkombëtare të profesionit dhe veprimtarisë së muzeve siç janë: Statuti i Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve dhe Kodi i Etikës Profesionale (ICOM).
15. Nxjerr udhëzime, urdhëresa, vendime dhe akte të tjera me të cilat udhëheq dhe orienton personelin e punësuar në MQK, në përmbushjen e detyrave zyrtare dhe profesionale në funksion të realizimit të veprimtarisë dhe mandatit të institucionit.
16. Është autoritet që vendos së bashku me këshillin drejtues për lëvizjet,

përdorimin, ripërdorimin, trajtimin veç e veç apo çfarëdo liste të objekteve me vlerë muzeore që janë pjesë e koleksioneve të Muzeut, për çfarëdo procesi të trajtimit të tyre, brenda territorit të Republikës së Kosovës, nën kushtet përkatëse të sigurisë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

17. Vendosë për kohëzgjatjen e ekspozitave të përkohshme.

Neni 12

Fondi Muzeor

1. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut administron fondin e vet muzeor dhe obligohet që ta ruajë të gjithë materialin muzeor, artefaktet, ekspozitat, materialet historike, aparaturat, instrumentet, veglat e ndryshme, dokumentacionin teknik si dhe materialet e tjera me vlerë muzeore (fototeka, diapozitivat, negativet, video dhe audio inçizimet).
2. Ruajtja, konservimi dhe menaxhimi i këtij fondi kryhet sipas rregullave të miratuara nga institucionet e specializuara në vartësinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, standardeve ndërkombëtare profesionale, si dhe rregulloreve të brendshme të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.
3. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut dhe muzetë e tjera publike ose private shkëmbejnë ndërmjet tyre objekte muzeore, pas miratimit të Këshillit Drejtues, në përputhje me legjislacionin, si dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet tyre.
4. Fondet e muzeut pasurohen vazhdimisht me objekte të trashëgimisë kulturore. Për këtë funksionon një komision i përbërë prej 5 personash, 3 specialistë të institucionit dhe 2 nga institucione të tjera të specializuara. Komisioni ngrihet me propozim të drejtorit, miratohet nga Këshilli Drejtues dhe mbledhet në çdo tre muaj.
5. Fondet e reja muzeore regjistrohen në inventarin e institucionit, i cili hartohet dhe administrohet nga MQK-ja.

Neni 13

Stafi profesional i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut

1. Në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë, detyrave dhe kompetencave të tij, MQK-ja organizon njësitë përkatëse organizative me punonjës të kualifikuar profesional të trashëgimisë kulturore që do të mbështesin procesin e hulumtimit, mbledhjes, inventarizimit, studimit, mbrojtjes, ruajtjes, konservimit dhe restaurimit, ekspozimit dhe promovimit të objekteve potenciale

me vlera të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.

2. Organizimi, sistematizimi dhe kompetencat e njësive organizative dhe të punësuarve në këto njësi, bëhen me aktin përkatës normativ sipas rregullave dhe parimeve të organizimit të institucioneve publike dhe të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës.

Neni 14

Stafi administrativ dhe teknik

1. Përveç stafit profesional MQK-ja ka edhe stafin administrativ dhe stafin teknik.
2. Numri i punëtorëve të stafit administrativ dhe teknik, përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e tyre përcaktohen me aktet normative mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
3. Stafi administrativ dhe stafi teknik i përgjigjen drejtpërdrejtë drejtorit të MQK-së.
4. Në rast të mos përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe atyre të veçanta të marrëdhënies së punës si dhe detyrave tjera zyrtare dhe profesionale nga stafi profesional, administrativ dhe teknik, drejtori i institucionit është përgjegjës për iniciimin, propozimin dhe marrjen e masave disiplinore, konform ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, statutit si akt i brendshëm dhe në përputhje me detyrimet e përcaktuara në aktet e themelimit të marrëdhënies së punës, gjegjësisht referencave.

Neni 15

Përgjegjësia, masat dhe procedurat disiplinore të stafit të punësuar në Muzeun e Qytetit të Kaçanikut

1. Kategoritë e të punësuarve në MQK, si punonjësit profesional, shërbyesit civil dhe stafi administrativ - teknik, në rastet e dështimit të përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të marrëdhënies së punës, respektivisht në rastet e dështimit të përmbushjes në kohë, sasi dhe cilësi të detyrave të punës, i nënshtrohen procedurave të brendshme disiplinore, gjegjësisht bartin përgjegjësi disiplinore në pajtim me Ligjin e Punës, Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet e tjera nënligjore, sipas llojit të aktit të themelimit të dhënies së punës, respektivisht, burimit juridik mbi bazën e të cilit është lidhur akti përkatës i marrëdhënies së punës.

2. Drejtori i MQK-së, në zbatim të detyrimeve të tij për të siguruar ligjshmërinë e punës dhe për të garantuar funksionimin e MQK-së, pas verifikimit të gjendjes faktike të shkeljes apo dështimit për të kryer me sukses detyrën është përgjegjës për shqiptimin e masave disiplinore për ato shkelje apo dështime në kryerjen e detyrës së punës, të cilat bazuar në ligjet dhe aktet normative në fuqi, konsiderohen shkelje të lehta të detyrave të punës

3. Drejtori i MQK-së në zbatim të detyrimeve të tij për të siguruar ligjshmërinë e punës dhe për të garantuar funksionimin e MQK-së, është përgjegjës për emërimin e organeve të brendshëm përkatëse për zhvillimin e procedurave disiplinore dhe procedurave të ankesave, të cilat merren me shqyrtimin e rasteve kur dyshohet se kanë ndodhur shkelje të rënda të detyrave të punës.

4. Për kategoritë e të punësuarve që i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, marrëdhënia e punës e të cilëve është rregulluar me Ligjin e Punës dhe akte tjera nënligjore, organet e brendshme të themeluara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, në punën e tyre, sa i përket procedurave të punës, do të zbatojnë përshtatshmërisht aktet nënligjore të shërbimit civil në Republikën e Kosovës për aq sa zbatimi i tyre nuk nënkupton shkelje të parimeve, procedurave dhe dispozitave tjera materiale të ligjeve përkatëse në fuqi që rregullojnë marrëdhënien e punës.

Neni 16

Bashkëpunëtorët e jashtëm të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut

1. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut mund të angazhojë bashkëpunëtorë të jashtëm për nevojat e brendshme.
2. Mënyra e angazhimit dhe kompensimit material të bashkëpunëtorëve bëhet konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi dhe me këtë Statut.

Neni 17

Mënyra e financimit

1. Mjetet buxhetore për punën e MQK-së sigurohen nga Komuna e Kaçanikut.
2. MQK-ja realizon mjete buxhetore edhe nga të hyrat vetanake, donacionet, sponsorizimet si dhe burime të tjera në përputhje me ligjet në fuqi.
3. Shfrytëzimi i donacioneve dhe të hyrave vetanake bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. MQK-ja ka xhironlogarin e mëvetëhsishme në njërin nga bankat e

licensuara të Kosovës.

5. Komuna e Kaçanikut angazhon një herë në vit një auditor për auditimin e pasqyrave financiare të MQK-së.

Neni 18

Ndërtesa, hapësirat dhe infrastruktura e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut

1. MQK-ja përkohësisht do të vendoset në ambientet e Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj" në Kaçanik, deri sa të krijohen kushtet për një ambient më të përshtatshëm.
2. Hapësirat e MQK-së përbëhen prej sallave apo galerive, të cilat shërbejnë si salla të ekspozitës së përhershme, kurse disa ekspozate janë të ekspozuara edhe në hollin qëndror të institucionit.
3. Në kuadër të MQK-së gjenden hapësirat e depove, ku ruhen koleksionet.

Neni 19

Arkivi

1. MQK-ja duhet të ketë të paktën 1 (një) arkivist kur të krijohen bazat financiare.
2. MQK-ja obligohet të ruajë gjithë dokumentacionin, regjistrin themelor, librat e inventarizimit, librat hyrës dhe dalës (informatorë, fletëpalosje, broshura, pllakatë, kataloge, fototekë, foto dhe audio dhe video inçizime, artikuj të gazetave të ndryshme, revista dhe materiale tjera), që formojnë dhe pasqyrojnë historinë dhe veprimtarinë e Muzeut, në arkivin e tij, në pajtim me Ligjin për Arkivat Shtetërore dhe legjislacionin në fuqi.

Neni

20

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi pas aprovimit në Kuvendin komunal , 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në ëeb faqen Komunës së Kaçanikut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01- 400/01-11503/24
Kaçanik; 17.05.2024

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61. të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit të Buxhetit 08-L/260 dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës propozon:

P r o p o z o n

Që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës që zhvillohet në muajin shtatorë 2024, të shqyrton dhe aprovon këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E TË HYRAVE TË TEJKALUARA NGA VITI 2023 NE VITIN 2024

I

Të Hyrat Vetanake (Fondi 21, gjobat e Gjykatave, Policisë dhe AGJPK) të realizuara gjatë vitit 2023 kanë qenë gjithësej 1,092,789.00 euro ndërsa planifikimi vjetorë ka qenë 862,578.00 euro. *Tejkalimi i të hyrave është në shumë prej 230,211.00 euro.*

II

Tejkalimi i të hyrave vetanake komunale të vitit 2023 është realizuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve:

- Kategoria e Investimeve kapitale shuma prej 125,211.00 euro;
- Kategoria e Subvencioneve dhe transfereve shuma prej 90,000.00 euro dhe
- Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve shuma prej 15,000.00 euro.

III

Destinimi apo kërkesa për bartje të kesaj shume planifikohet të bëhet:

- a) PB – Zyra e Kryetarit - nënprogrami (16028), shuma prej 90,000.00€ në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve;
- b) PB – Administrata e Përgjithshme - nënprogrami (16328), shuma prej 10,000.00€ në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve dhe
- c) PB – Buxheti - nënprogrami (17528), shuma prej 5,000.00€ në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve dhe shuma prej 125,211.00€ në kategorinë e Investimeve kapitale në projektin “Mjetet për bashkëfinansim të projekteve” me kod 86245.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

V

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.



Besim ILAZI,
Krytar i Komunës

Bleq



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01-Nr. 400/01-11581/24
Kaçanik; 17.05.2024

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjit Nr. (Nr.08/L-260) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, te nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR TRANSFERIN E MJETEVE NGA REZERVA KOMUNALE SIPAS BUXHETIT TË VITIT
2024

Përmes këtij Propozim Vendimi, bëhet transferi i mjeteve nga Rezerva Komunale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në shumën e përgjithshme prej **25,000.00** euro, sipas tabelës të Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-260 për vitin 2024, si në vijim:

1. Transferet-fondi 10 (Granti Qeveritar)

Nga Nën-Programi Buxhetor – Infrastruktura rrugore 18028 kodi funksional 0451 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 20,000.00 €
→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Infrastruktura rrugore 18028 kodi funksional 0451 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 20,000.00 €.

2. Transferet-fondi 21 (Të hyrat vetanake)

Nga Nën-Programi Buxhetor – Infrastruktura rrugore 18028 kodi funksional 0451 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 5,000.00 €
→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Infrastruktura rrugore 18028 kodi funksional 0451 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 5,000.00 €.

1. Pjesë përbërëse e këtij Propozim-Vendimi janë Formularet standard nga MFPT. të plotesuara me shumën e lëvizura sipas Nën-Programëve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve.
2. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

Kryetari i Komunës:

Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministrarstvo za Financije - Ministry of Finance
Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Department

KËRKESA PËR TRANSFER

PJESA 1: TË DHËNAT E TRANSFERIT

Emri i organizatës buxhetore	Komuna Kaçanikut	Kodi	652
Emri i nën-programit	Infrastruktura rrugore	Kodi	18028

Kodi organizativ	Kodi i nën-programit	Kodi funksional	Burimet e Financimit	Emërtimi i Projektet	Kodi i projektit	Kategoria shpenzimeve	Aprovimi i tanishëm	Shuma e ndryshimit	Aprovimi i ri	Buxheti Aprovuar/Rishikuar	Totali i shumës së transferuar/rialkuar	% Transferit/Rialokimit (i ri ndaj buxhetit)
652	18028	0451	10	Rezerva		38	20,000.00	(20,000.00)	-	20,000.00	(20,000.00)	
652	18028	0451	21	Rezerva		38	5,000.00	(5,000.00)	-	5,000.00	(5,000.00)	
652	18028	0451	10	Mallra dhe Shërbime		30	315,000.00	20,000.00	335,000.00	315,000.00	20,000.00	
652	18028	0451	21	Mallra dhe Shërbime		30	-	5,000.00	5,000.00	-	5,000.00	
Totali							340,000.00	-	340,000.00	340,000.00	-	

PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË TRANSFERUAR

(Shëno Po ose Jo)	Transferi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve	PO	JO
	Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rrjedhës së parasë?	PO	
		PO	

PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)

Eliminim i rezervës komunale bëhet përshkak të plotësimit të fondeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve

ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ËSHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PERFAQËSON PËRDORIM E FIKTIV DHE EFIKAS TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

Zyrtari kryesor financiar	Data	Zyrtari Kryesor Administrativ / Kryeshefi Ekzekutiv	Data
Valdrin Dogani	17.05.2024	Boşim Ilazi	17.05.2024

PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI

ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)

KËRKO NDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE	Data	NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFIKINGA*	Data
Drejtori i Buxhetit		Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave*	
Drejtori i Departamentit të Buxheteve Komunale z.Salvador Elmazi		NUMRAT E KD	

Vrejtje:

*Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategorinë e shpenzimeve të nën-programit





01.Nr. 104/02-11634/24
Datë 17.05.2024

Në mbështetje të nenit 58, shkronja (h) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), si dhe të nenit 22 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 27, të rregullore (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6 pika 2 shkronja (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës të merre këtë :

PROPOZIM VENDIM PËR SHKËPUTJE TË KONTRATËS

Me nr protokollit 104/02-39284/2019 të datës 12.12.2019

1. Kuvendit të komunës për miratim të vendimit për **SHKËPUTJE TË KONTRATËS** *Me nr protokollit 104/02-39284/2019 të datës 12.12.2019*, E lidhur në Komunën e Kaçanikut me 12 Dhjetor 2019 ndërmjet: Komuna e Kaçanikut, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe z.Mevlud Zharku i lindur më datë 21.11.1984, Nr.personal; 1500027319.

Arsyetim

Propozimi për iniciimin për shkeputje te Kontrates se lartecekur behet duke u bazuar ne raportin per mbikqyrjen e realizmit te kontrateve per dhenien ne shfrytezim te prones se paluajtshme te Komunes se Kacanikut, sipas planit dinamik ralizues me nr. 01/104/02-7153/2023, te dates 21.03.2023, Njoftimin e dates 26.03.2023, raportit te dates 18.10.2023.

Investitori nuk i ka përmbushur zotimet e tija sipas kontratës dhe detyrimet të tij për marrje në shfrytëzim afatgjat të parcelës komunale për zhvillim ekonomik dhe se i nijeti ka shitur Fabriken e Betonit sipas Kontrates për Shitblerjen e Fabrikes së Betonit e lidhur me datën 29.12.2023 dhe e cila është vërtetuar nënshkrimi i kontrates te Noteri Naser S. Pajaziti me numër rendor 3271/2023 me datë 29.12.2023, këtë kontratë e ka prezentuar përgjegjësi i Kompanis GERMAN BETON SH.P.K. dhe e cila kontratë është e lidhur ndërmjet : M&V Group Company SH.P.K. e regjistruar në zyrën e bizneseve në Kaçanik, me NRB. 811386045, , me adresë në Rr. Qardak, PN, fsh. Kaçanik i Vjetër, Kaçanik e përfaqësuar nga Pronari Burim (Bajram) Zharku me numër personal 1004566188 me vendbanim në Fsh. Bob, Kaçanik si **SHITËS** dhe GERMAN BETON SH.P.K. e regjistruar në zyrën e bizneseve në Kaçanik, me NRB. 811992602, me adresë në Rr. Qardak, PN, fsh. Kaçanik i Vjetër, Kaçanik e përfaqësuar nga Pronari Fatlum (Rushit) Blenishti me numër personal 1011866936 me vendbanim në Fsh. Zaskok, Ferizaj si **BLERES**. Në objektin e kontrates janë të përshkruar sendet të cilat janë shitur si pron e Luajtshme (makineri) dhe për të cilët palët bihen dakort në shumen prej 151,000.00 Euro për blerje dhe te nenit të 4 të kontratës gjegjësisht te regjistrimi, ku thuhet palët kanë rënë dakord që blersi pas autorizimit të kontratës ka të drejt që ti kryej të gjitha aplikimet rreth bartjes (transferimit) të lejeve, pëlqimëve dhe licensave komunale dhe shtetore të operimit të subjektit në këtë rast GERMAN BETON SH.P.K.

Po ashtu, sipas kontratës dhe ofertës për marrjen e pronës së komunës e cila është lidhur me dt 12.12.2019 me ofertuesit, z. Mevlud Zharku, i lindur më datë 21.11.1984, Nr. personal; 1500027319, ID 0423468 e lëshuar me datë 26.11.2015 nga MPB-Republika e Kosovës i cili me datën 06.01.2020 e ka regjistruar në zyrën e bizneseve në Kaçanik biznesin me emer tregtar: **M&V Group Company SH.P.K.** me NRB. 811386045, me adresë në Rr. Qardak, PN, fsh. Kaçanik i Vjetër, Kaçanik me Pronar z. Mevlud Zharku me numër personal 1500027319 me vendbanim në Fsh. Bob, Kaçanik, ndersa me datën 19.02.2020 është bërë ndryshimi i pronarit nga z. Mevlud Zharku në pronarin e ri Burim (Bajram) Zharku me numër personal 1004566188 me vendbanim në Fsh. Bob, Kaçanik. Ky ndryshim është bërë sipas Vendimit mbi ndryshimin e Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, i cili vendim është i nënshkruar nga pronari i vjetër z. Mevlud Zharku dhe pronari i ri Burim (Bajram) Zharku i datës 19.02.2020 si dhe Marrëveshja për Faljen Të Aksioneve të datës 19.02.2020.

Të bashkangjitura i gjeni si dëshmi:

- *Kontrata me nr protokollit 104/02-39284/2019 të datës 12.12.2019*
- *Raportin për mbikqyrjen e realizimit të kontratave për dhenien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunes së Kaçanikut, sipas planit dinamik realizues me nr. 01/104/02-7153/2023, të datës 21.03.2023,*
- *Njoftimin e datës 26.03.2023 dhe raportit të datës 18.10.2023.*
- *Kontrata për shitblerjen e Fabrikes së Betonit e lidhur me datën 29.12.2023, dhe e cila është vërtetuar nënshkrimi i kontratës nga Noteri Naser S. Pajaziti me numër rendor 3271/2023 të datës 29.12.2023,*
- *Vendimit mbi ndryshimin e Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar i datës 29.02.2020*
- *Marrëveshja për Faljen Të Aksioneve të datës 19.02.2020.*

Nga të theksuarit si më lartë u propozua për miratim si në dispozitiv të këtij Propozim – Vendimi

Drejtori I DUKMM-së
z. Qamijl Stagova



KONTRATË PËR SHITBLERJEN

E

FABRIKËS SË BETONIT

Me datë 29.12.2023 (njëzetënëntë/dhjetor/dymijë e njëzet e tre) në Kaçanik të Vjetër me vullnet të plotë në mes palëve përpilohet kjo kontratë:

NENI 1

Palët

"M&V Group Company" SH.P.K., me NUI: 811388045 me seli në Kaçanik të Vjetër, Çardak p.n., Kaçanik përfaqësuar nga pronari Burim Zharku i lindur më 18.04.1981 në Kaçanik, me vendbanim në fshatin Bob Komuna e Kaçanikut, me numër personal të letërnjoftimit 1004566188 i lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës - si shitës

dhe

"GERMAN BETON" SH.P.K., me NUI: 811992602, me seli në Kaçanik të Vjetër, Çardak, p.n., Kaçanik, përfaqësuar nga pronari Fatlum Blenishti, i lindur me datë 07.10.1982, në Ferizaj, Republika e Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit 1011866936 me vendbanim në fshatin Zaskok, Komuna e Ferizajt – blerësi.

NENI 2

Objekti

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitblerja e Fabrikës për Prodhimin e Betonit me vendndodhje në Kaçanik të Vjetër , Çardak.

Përshkrimi i objektit të kontratës

Palët dakordohen që të përfshihen këto elemente:

- 1.Bunkerët e agregatit 4x30= 120 m³ së bashku me pistonat dhe pajisjet përcjellëse;
- 2.Transportieri horizontal mbledhës – dozatori;
- 3.Transportieri i pjerrët furnizues i agregatit;



4. Pëzierësja e betonit – mikseri (Q=120 m³/h);
5. Silosët e çimentos (me vëllim V=2 x 100 t = 200 t);
6. Transportierët kërmillor nga silosët e çimentos (2 x Ø 273 x 12.000 mm);
7. Kompresori i ajrit të komprimuar (P=11.0 kW, 2100 litra/min);
8. Pompat për aditivët e çimentos;
9. Kabina e komanduese e Bazës së Betonit;
10. Rezervuari dhe pompa e ujit me pajisje përcjellëse;
11. Hapësira për deponimin e agregatit;
12. Gjeneratori me naftë me fuqi: P=400 kVA, 230/400 V;
13. Trafo elektrike me fuqi: P=400 kVA.
14. Mjetet e punës në zyret e kompanisë, dy kompjutera, serveri i IT me kamerat vëzhguese;
15. Orenditë e objektit dhe orenditë tjera përfshirë ashensorin lëvizës dhe pjesët e tjera si pasuri e luajtshme.
16. Autobetonjerë, Marka: Mercedes Benz, Tipi G 3236 B42Actros, KW265, Com-19460, Dyer-2, Ulëse-2, Ngjyra e bardhë, KM-451763, P. Bartëse: 18480 kg, Viti i prodhimit_2007, Referenca doganore R.4991, dt. 03/03/2021
17. Pompë betoni, Marka: mercedes Benz Aroccs, Nr i tabelave: 01 48550, nr i shasisë: NMB96423112184504

NENI 3

Detyrimet e subjekteve nga puna juridike

Çmimi

Të dy palët kontraktuese janë dakorduar që vlera e përgjithëshme e shitblerjesë të jetë në vlerë prej 151,000.00€ (njëqind e pesëdhjetë e një mijë euro e zero cent).

Mënyra e pagesës

Palët dakordohen që pagesa të kryhet brenda 90 ditëve nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate në xhirollogarinë e shitësit në BPB me nr..kontos: 1302001002773184



NENI 4



Regjistrimi

Regjistrimi

Palët bien dakord që blerësi pas noterizimit të kontratës ka të drejtën që të kryej të gjitha aplikimet rreth bartjes (transferimit) të lejeve, pëlqimeve dhe licencave komunale dhe shtetërore të operimit të subjektit në këtë rast "GERMAN BETON" SH.P.K.

Përdorimi i pasurisë

Palët janë marrë vesh që pas nënshkrimit të kontratës të njejtën të e noterizojn tek noteri i kompetencës territoriale në cilien gjendet pasuria e kësaj kontrate.

Ngarkesat

Palët bien dakord që pasuria e cila është objekt i kontratës nuk është në asnjë formë të ngarkesave si e tillë është e lirë dhe pa të meta juridike dhe fizike në qarkullimin juridik.

OBLIGIMET E MBETURA TË SHITËSIT DERI NË NËNSHKRIMIN E KËSAJ KONTRATE MBETEN OBLIGIME TË TIJ DHE BLERËSI NUK MERR PËRGJEGJËSI MBI TO.

NENI 5

Zgjidhja e mospërmbushjes

Mënyra e zgjidhjes

Në mes palëve për çdo kontest eventual, së pari do të vlejë parimi i negociatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kompetente që të vendos do të jetë Gjykata Themelore në Ferizaj – dega Kaçanik.

NENI 6

Efkti i kontratës

Klauzola e ekzekutueshmërisë

Palët janë marrë vesh që pas nënshkrimit të kontratës të njejtën të e noterizojnë – vërtetojnë tek noteri i kompetencës territoriale në të cilien gjendet pasuria e kësaj kontrate dhe pas noterizimit kjo kontratë merr formë të ekzekutueshmërisë - përmbarimit.

NENI 7

Dispozita përfundimtare

Originali i kontratës

Kontrata hartohet në katër faqe me nga 4 (katër) kopje autentike ku secila palë ruan nga 2 (dy) kopje të saj.



Hartimi

Kontrata është hartuar në gjuhën kombëtare të palëve në gjuhën shqipe dhe për çdo ndryshim të saj palët me marrëveshje mund të ndryshojn gjuhën e kësaj kontrate.

NENI 8 Pjesa përmbyllëse

Deklarimi se puna juridike bëhet me vullnet

Palët me vullnet të plotë, pa ndikim, pa mashtrim apo ndonjë formë të lajthimit juridik apo faktik kanë arritur të e lidhin këtë kontratë të shitblerjes së pasurisë.

Pagesa e tarifës

Palët bien dakord që shpenzimet e hartimit të kësaj kontrate si dhe vërtetimin tek noteri të bien mbi barrën e blerësit dhe atë në bazë të tarifave sipas legjislacionit në fuqi.

Kontrata është lidhur në Kaçanik të Vjetër, Komuna e Kaçanikut me datë: 29 dhjetor 2023.

Shitësi:

M&V
GROUP
COMPANY

Burim Zharku

Blerësi:

GERMAN
BETON

Fatium Blerishi



REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER:

NASER S. PAJAZITI

KAÇANIK

Numri rendor:3271/2023

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Unë,NOTER –Naser Pajaziti ,me zyrë noteriale në Kaçanik, bulevardi "Ismail Raka" ---
nr.185,-----

Vërtetoj : "M&V Group" SH.P.K, identifikuar sipas Çertifikatës së biznesit numër
unik identifikues 811386045, me seli në Kaçanik i Vjetër, Komuna e Kaçanikut-
Çardak, të cilën e përfaqëson: zt.Burim Zharku, i lindur në Kaçanik, më 18.04.1981
(Tetëmbëdhjetë Prill Një Mijë e Nëntëqind e Tetëdhjetë e Një), me vendbanim të ----
përhershëm në Bob, Komuna e Kaçanikut, identiteti i të cilit konstatohet nga -----
Letërnjoftimi me nr.personal 1004566188, të lëshuar nga RKS-MPB,me date-----
12.10.2016, dhe -----

"German Beton" Sh.P.K, identifikuar sipas Çertifikatës së biznesit me nr.unik -----
identifikues 811992602, me pronar: zt.Fatlum Blenishti, të cilën përmes autorizimit
me numër 11066/2023, të përpiluar më date 26.04.2023 tek noteri Selatin -----
D.Shahini, me seli në Ferizaj, rruga "Reçakut" p.n, e përfaqëson: -----
zt. Ali Qazimi, i lindur në Greme, Komuna Ferizaj, më 17.07.1970 (Shtatëmbëdhjetë -
Korrik Një Mijë e Nëntëqind e Shtatëdhjetë), me vendbanim të përhershëm në -----
Greme, Komuna Ferizaj, identiteti i të cilit konstatohet nga Letërnjoftimi me nr. -----
personal 1030288897, të lëshuar nga RKS-MPB, më datë 17.01.2019.-----

nën praninë time kanë nënshkruar me dorë të vetë këtë Kontratë për Shitblerjen e
Fabrikës së Betonit, dhe e kanë vertetuar me vulat e firmës, "M&V Group" SH.P.K
dhe "German Beton" Sh.P.K,-----

Identitetin e të lartëpërmendurve e kam vërtetuar në bazë të Letërnjoftimve, me nr.
ID0632854 dhe ID1171846, të lëshuar nga MPB Kosovës ,që më janë prezentuar.- ---
Nënshkrimi dhe vula e lartëpërmendurve në dokumentin e cekur Kontratë për ----
Shitblerjen e Fabrikës së Betonit , është vënë në secilën faqe, dhe është autentik.-- -
Shpenzimet janë paguar nga pala në vlerë prej 16,90 euro+ 18%Tvsh bazuar në -----
tarifën nr 05, bazë për pagesën e shërbimit të noterëve.-----

Bazuar në Ligjin mbi Noterinë ,Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen dhe nuk -----
obligohet nese pala ka apo jo të drejtë në lidhjen e kësaj pune çka përmban ky -----
dokument.-----

Në Kaçanik, me 29.12.2023 (Njëzet e Nëntë Dhjetor Dy Mijë e Njëzet e Tre).-----

NOTERI: Naser S. Pajaziti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Në mbështetje të nenit 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/15, Qershor 2008), nenit 19 pragrafi 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019, Vendimin e Kuvendit të Komunës 01Nr.104/02-15795/2019 i datës 31.10.2019, Konfirmimi i ligjshmërisë - MAPL-së Nr.020-1131, datë 15/11/2019, Kryetari i Komunës lidh kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese:

KONTRATË PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

E lidhur në Komunën e Kaçanikut me 12 Dhjetor 2019 ndërmjet:

- 1) Komuna e Kaçanikut, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe
- 2) z.Mevlud Zharku i lindur me datë 21.11.1984, Nr.personal; 1500027319, ID 0423468 e lëshuar me date 26.11.2015 nga MPB-Republika e Kosoves.

Neni 1.

Lënda e Kontratës:

Duke ju nënshtruar kushteve të parashtruara në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues i jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë) vite z.Mevlud Zharkut parcelën kadastrale Nr.P-70917086-01407-0, zona kadastrale Kaçanik i Vjetër në vendin Çardak, sipërfaqja e aprovuar 2.5930 ha, pronë shoqërore e K.K Kaçanik.

Neni 2.

Autoriteti Kontraktues është pronar i pronës së paluajtshme komunale të përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, në tekstin në vijim e referuar si "objekti i kontratës".

Neni 3.

E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë.

Neni 4.

5.1 Objekti i kontratës është i paradestinuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitete afariste të bizneseve, për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal. z.Mevlud Zharku do të shfrytëzoj objektin e kontratës për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve afariste – **Ndërtimin e Fabrikës për prodhimin e elementeve të betonit, Autolarje Automatike, Ndërtimi i objekti Hotelier**, sipas projekt propozimit të paraqitur tek Autoriteti Kontraktues dhe kushteve të zhvillimit të projektit.

5.2 Shfrytëzuesi i pronës komunale z.Mevlud Zharku është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

5.3 Shrytëzuesi i pronës së paluajtshme të komunës obligohet që ti përmbahet planit dinamik realizues (në pajtim me dokumentacionin e ofruar me 01Nr.104/02-15826 të datës 29.05.2019).

Neni 5.

Objekti i kontratës

7.1. Autoriteti Kontraktues i'a jep në shfrytëzim pronën komunale, z.Mevlud Zharku, i cili merr në shfrytëzim nga Autoriteti Kontraktues objektin e përshkruar si në vijim:

7.2. Fleta poseduese

7.3. Parcela

7.4. Madhësia e tokës

7.5. Të dhëna tjera në lidhje me tokën.

Neni 6.

Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm:

8.1.Duke iu nënshtruar edhe afateve të tjera të kësaj Kontrate, kohëzgjatja e kësaj Kontratë për dhënjën në shfrytëzim afatgjate të pronës së paluajtshme të Komunës është për **99 vite**, që fillon të llogaritet nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

8.2. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Me këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

8.3. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit.

8.4 Nëse shfrytëzuesi i pronës nuk i plotëson njërin nga kushtet e kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues mund të anulojë këtë Kontratë, duke e njoftuar me shkrim shfrytëzuesin e pronës komunale për këtë dhe të kërkojë dëmshpërblimin sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 7.

9.1 Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

9.2 Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

9.3. Pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund t'i vazhdohet afati në bazë të performancës.

Neni 8.

Mbikëqyrja e kontratave:

10.1. Komuna mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues.

10.2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Neni 9.

Shfrytëzuesi i pronës komunale z.Mevlud Zharku , obligohet ti përmbahet vendimit të Kuvendit të Komunës **01Nr.104/02-15826/2019** i datës **31.10.2019**, në rast të mos përmbushjes së tyre Kryetari i Komunës ka të drejtë ta shkëpus kontratën në mënyr të njëanshme.

Neni 10.

Shfrytëzuesi i pronës komunale, obligohet që pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ti përmbahet afatit të paraparë në planin dinamik, projektin ideor, të përgatisë të gjithë infrastrukturën e nevojshme ligjore për fillimin e punimeve, duke siguruar shfrytëzimin apo destinimin e saj në të mirë dhe interes të përgjithshëm të qytetarëve.

Neni 11.

Kontestet eventuale lidhur me këtë kontratë, kontraktuesit do ti zgjidhin me mirëkuptim dhe marrëveshje, dhe në rast se këtë nuk mund të arrijnë atëherë kontestet do të zgjidhen në Gjykatën Kompetente.

Neni 12.

Kjo kontratë është përpiluar në ekzemplar të mjaftuar për palën kontraktuese, palët kontraktuese e kanë lexuar dhe kanë kuptuar përmbajtjen e kësaj kontrate, dhe në shenjë të pajtimit të vullnetit të tyre e nënshkruajnë pa vërejtje.

Neni 13.

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrim nga ana e palëve kontraktuese.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut

z.Besim Ilazi



z. Mevlud Zharku

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E KACANIKUT KACANIK		
D. 13-12-19	Nomi KACANIK	
№	Nr. p.	Shtojcë
01	104/02-39284	/

Themeluesit - pronarët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara " M&V Group Company " SH.P.K. që ka numrin e biznesit 811386045 , konform Ligjit mbi shoqërit tregtare (Ligjit Nr.06/L-016) neni 26,28 dhe 40 më datë 19.02.2020 mori këtë vendim :

VENDIM

MBI NDRYSHIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "M&V Group Company"SH.P.K.

Neni 1

1.1.Kuvendi i aksionarëve të shoqërisë - pronarët e "M&V Group Company"SH.P.K. me seli në Kaçanik që ka numrin e biznesit 811386045 marrin vendim për ndryshimin e

Statutit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar,

- Ndryshimin e Pronarëve , ku fillimisht largohen Mevlud Zharku me ID. 1500027319,duke u shtuar si pronar i ri Burim Zharku me ID. 1004566188 me 100% zotrim të aksioneve si pronar i vetëm .

Neni 2

Shoqëria "M&V Group Company"SH.P.K. nga dita e sotme ndryshon statutin për shkak ndryshieve të cekura më lartë.

Neni 3

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohen : MTI - QKRB në Kaçanik dhe arkivi i shoqërisë.


Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe do të zbatohet nga data e regjistrimit të ndryshimeve në ARBK.

Kaçanik, 19 Shkurt 2020


Pronari :

z.Mevlud Zharku



Pronari i ri :

z.Burim Zharku



MARRËVESHJE PËR FALJE TË AKSIONEVE

Pronarët aktual z.Mevlud Zharku me ID.1500027319 vendos që t'ia fal aksionet z.Burim Zharku me ID.1004566188 nga Kaçaniku .


“ M & V GROUP COMPANY ” SH.P.K. me NRB. 811386045 në kohën e themelimit ka regjistruar 300 aksione me vlerë nga 1000€ në totalë prej 300.000€ të cilat janë në posedim të Mevlud Zharku me 100% të aksioneve .

100% të cilat janë në emër të Mevlud Zharkut kalojnë në emrin e pronarit të ri Burim Zharku .

Ky kalim i aksioneve prej pronarëve aktual në pronarin tjetër bëhet me marrëveshje .

Dt.19.02.2020

z.Mevlud Zharku



z. Burim Zharku





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

1	Data	21.03.23	Vendi	KAÇANIK
2	Nr. org.	01	Numri	104/02-2953
3	Shtojc			

**KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E REALIZIMIT TE KONTRATAVE PËR DHËNIEN
NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË
KOMUNËS SË KAÇANIKUT SIPAS PLANIT DINAMIK REALIZUES**

Në mbështetje të Vendimit për formimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues 01nr.104/02-31608/2022, te datës 29.11.2022, Plotësimi Vendimi i datës 27.01.2023 si dhe në bazë të kontratës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së komunës nr.01-104/02-39284/2019 e lidhur me datën 12.12.2019, në parcelën kadastrale P-70917086-01407-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues përpilon këtë:

RAPORT

Duke ju referuar Vendimit për formimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues 01nr.104/02-31608/2022, te datës 29.11.2022, Plotësimi Vendimi i datës 27.01.2023 si dhe duke u bazuar në nenin 8 të kontratës pika 10.1 dhe 10.2 e cila ka të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik, komisioni në përbërje të plotë doli nëpër lokacione me qëllim të verifikimit dhe regjistrimit të punimeve duke u bazuar në planin dinamik realizues.

Gjatë punës nëpër teren kemi hasur në vështirësi për shkak të natyrave të ndryshme të punës, kushteve atmosferike, koha e shkurtër e regjistrimit por, në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të institucioneve të ndryshme kemi arritur që të bëhet puna efektive.

Komisioni gjatë punës ka bërë mbikëqyrjen e kontratës të Z. Mevlud Zharku me nr. të kontratës 01-104/02-39284/2019, të datës 12.12.2019 e lidhur me Komunën e Kaçanikut, kontrata për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për 99 vite është nënshkruar nga të dy palët e cila pronë gjendet në zonën kadastrale Kaçanik I Vjetër me nr. Te parcelës Nr.P-70917086-01407-0, me sipërfaqe të aprovuar 02.59.30ha,

Duke u bazuar në nenin 8 të kontratës pika 10.1 dhe 10.2 e cila ka të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik, komisioni ka dalur në vendin e quajtur Çardak në zonën kadastrale Kaçanik I Vjetër, ofertuesi ekonomik z. Mevlud Zharku dhe ka mbajtur procesverbal mbi inspektimet e kryera dhe në të cilën janë përshkruar shënimet e përgjithshme për subjektin e inspektuar, përshkrimi i kontrollimit, Dokumentacioni, përshkrimi i objektit, vendit të inspektuar dhe konstatimin, andaj komisioni duke u bazuar në kontratën për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për 99 vite e cila është nënshkruar nga të dy palët, si dhe procesverbali i datës 12.12.2022 bëjnë përshkrimin e këtij raporti duke u bazuar në pikat si më poshtë:

1. Kontrata
2. Shënimet e aktuale për subjektin e inspektuar
3. Përshkrimi i kontrollimit
4. Dokumentacioni
5. Përshkrimi i objektit të vendit të inspektuar dhe
6. Konstatimin

Gjatë përshkrimit të pikave si më lart do të përshkruhet gjendja faktike më gjendjen e ofertuar nga ofertuesi dhe në fund të çdo pike do të behet konstatimi i gjendjes reale me atë të ofertuar dhe shkelja e neneve të kontratës.

1. KONTRATA

KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

E lidhur në Komunën e Kaçanikut me 12 Dhjetor 2019 ndërmjet: Komuna e Kaçanikut, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe z.Mevlud Zharku i lindur më datë 21.11.1984, Nr.personal; 1500027319, ID 0423468 e lëshuar me datë 26.11.2015 nga MPB-Republika e Kosovës. E gjeni të bashkangjitur si dokument shtesë, (Kontratën).

2. SHËNIMET AKTUALE PËR SUBJEKTIN E INSPEKTUAR

Shënime të përgjithshme për subjektin e inspektuar ne teren:	
Emri i subjektit te inspektuar	SHPK GERMAN BETON
Personit përgjegjës	ALI QAZIMI me nr. personal 103028897
Emri i Personit Fizik (pronarit).	FATLUM BLENISHTI
Adresa	KAÇANIK I VJETËR, RR. ÇARDAKU, PN
Komuna	KAÇANIK
Numri i regjistrimit të biznesit	
Lloji i Veprimtarisë	PRODHIM I BETONIT TË LËNGËT
Numri kontaktues	044/981-015, (numri i kontabilistit)
Legjislacioni i aplikuar në këtë inspektim.	Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr. 06/L-092: Rregullore (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

KONSTATIM

Gjatë inspektimit në vendim e ngjarjes janë kërkuar dokumentet e nevojshme lidhur me qarkullimin e biznesit dhe për të cilën ne kemi kërkuar sipas kontratës, mirëpo gjatë inspektimit personi përgjegjës lidhur me shpjegimin nga ana e komisionit, (lidhje me kontratën dhe ofertën për marrjen e pronës së komunës), nuk ka qenë në dijeni për kontratën e lidhur dhe gjatë inspektimit vërejtëm se po në këtë pronë është themeluar edhe një biznes i ri me emër SHPK GERMAN BETON, me nr të biznesit 811992602, me pronar Fatlum Blenishi, ndërsa në Agjencionin e regjistrimit të biznesit figuron edhe biznesi me emër M&V Grup Company Sh.P.K. me numër të biznesit 811386045 me pronar Burim Zharku si biznes aktiv, Pra gjatë shqyrtimit të dokumentacioneve lidhje me shënime të përgjithshme për subjektin e inspektuar në teren, konstatuam që në këtë pronë sipas kontratës së lidhur për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale figurojnë të regjistruar dy biznese dhe komisioni konstaton që këtu kemi të bëjmë me udhëim të pronarit ngase në asnjë prej bizneseve nuk është i regjistruar emri i pronarit sipas ofertës me të cilën ka fituar pronën e komunës për shfrytëzim, dhe nënkuptohet që është shkelur neni 3 i kontratës ku thuhet E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë dhe në bazë të vlerësimit të pronarëve nënkuptohet që biznesi në fjalë është bartur në emër të pronarit SHPK GERMAN BETON, sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr. 06/L-092 si dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës në ligjin neni 19 pikë 5 ku thuhet: E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë. Dhe në bazë të shqyrtimit të dokumenteve konstatuam se po në këtë parcelë emri i përfituesit të ofertës nuk është i shënuar askund si pronar i biznesit dhe në bazë të kontratës konstatuam që është shkelur neni 3 i kontratës ngase sipas dokumentacionit konstatuam që kemi të bëjmë me personin e tretë.

3. PËRSHKRIMI I KONTROLLIMIT.

Gjatë inspektimit në kemi bërë kontrollimin e dokumentacioneve duke u bazuar në ofertën me të cilën ofertuesi ka fituar pronën në shfrytëzim për 99 vite, si dhe kontratën e cila është lidhur me datën 12.12.2019.

DOKUMENTACIONET E KONTROLLUAR

- PLANI DINAMIK INVESTIV
- PLANI I BIZNESIT
- PROJEKTI IDEOR
- VLERA E INVESTIMEVE
- NUMRI I TË PUNSUARËVE
- LEJA NDËRTIMORE
- LEJA MJEDISORE KOMUNALE

- PLANI DINAMIK INVESTIV – përshkrimi sipas ofertës

Sipas ofertuesit plani dinamik investiv ka qenë i realizueshëm siç ka kërkuar ofertuesi të jetë në dy faza të cilat faza kanë qenë për të përfunduar brenda 1 viti kalendarik.

Përshkrimi i punëve në Fazën e parë -I-

1. Projekti ideor - i cili duhet të përfundoj në muajin e parë.
2. Pastrimi i vende të punishtës - i cili duhet të përfundoj në muajin e dytë
3. Vendosja e rrethojave mbrojtëse - e cila duhet të përfundoj në muajin e dytë
4. Pikimi gjeodezik - i cili duhet të përfundoj në muajin e tretë
5. Hapja e themeleve të pllakës - i cili duhet të përfundoj në muajin e katër.

Në fazën e parë punët e realizuar sipas inspektimit, janë përfunduar të gjitha punët sipas planit dinamik realizues të cilën ka kërkuar ofertuesi.

Përshkrimi i punëve në Fazën e dytë -II-

1. Transporti i makinave punuese - i cili duhet të përfundoj në muajin e pestë dhe të gjashtë.
2. Montimi i makinave të punës - i cili duhet të përfundoj në muajin e shtatë dhe të tetë.
3. Përfundimi i autolarjes - i cili duhet të përfundoj në muajin e nëntë.
4. Përfundimi i ndërtimit të fabrikës - i cili duhet të përfundoj në muajin e dhjetë dhe njëmbëdhjetë
5. Përfundimi i restorantit - i cili duhet të përfundoj në muajin e dymbëdhjetë.

Komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues

Në fazën e dytë punët e realizuara sipas inspektimit nuk janë përfunduar të gjitha punët sipas planit dinamik të cilën ka kërkuar ofertuesi.

KONSTATIM

Në Fazën e parë gjatë inspektimit lidhur me planin dinamik investiv, me të cilin ka aplikuar ofertuesi përshkrimi i cili është bërë që të jetë si në ofertën me të cilin ka aplikuar nuk përputhet dhe nuk janë as nga pamja edhe as nga hapësira brenda qysh ka kërkuar ofertuesi;

- ❖ Pastrimi i vend punishtës (është bërë sipas planit dinamik)
- ❖ Vendosja e rrethojave mbrojtëse (është bërë sipas planit dinamik)
- ❖ Pikturimi gjeodezik (nuk kemi pasur ndonjë dokument që vërteton për kryerjen e kësaj pike)
- ❖ Hapja e themeleve të pllakës (gjatë inspektimit objekti në fjalë është i ndërtuar mirë por jo sipas projekti ideor).
- ❖ Transporti i makinave punues (është arritur faza e parë vetëm në makineri transportuese)
- ❖ Montimi i makinave të punës (është arritur vetëm makineria e prodhimit të betonit të lëngët, dhe jo makineri për prodhimin e produkteve të përshkruar si në planin e biznesit)
- ❖ Përfundimi i autolarjes (gjatë inspektimit nuk ka objekte për autolarje)
- ❖ Përfundimi i ndërtimit të fabrikës (gjatë inspektimit nuk ka filluar akoma fabrika për tu ndërtuar)
- ❖ Përfundimi i restorantit objekti i ndërtimit (është i përfunduar mirë por, në hapësirën brenda objektit është pa përfunduar).

Në përfundim komisioni konstaton se gjatë kontrollimit të dokumentacionit dhe daljes në teren për verifikimin sipas planit dinamik realizues, ofertuesi ka shkelur pikat e planit dinamik sipas përshkrimit të ofertuar në pikat e cekura si më lartë, andaj ne si komision rekomandojmë që plani dinamik nuk është realizuar sipas ofertës për të cilin ka fituar pronën dhe nga plani dinamik koha e investimit ka qenë 12 muaj apo 1 vit kalendarik dhe me të cilin sipas kontratës realizimi i punimeve ka qenë dashur të filloj nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Ofertuesi nuk iu ka përmbajtur planit dinamik investues sipas ofertës me të cilin ka fituar pronën në shfrytëzim. (shiko Figurën 1)




Figura 1 (Plani dinamik realizues sipas ofertës)

4. PLANI I BIZNESIT – përshkrimi sipas ofertës

Synim i kamotshëm i jonë ka qenë që kapacitetin intelektual dhe financiar të grumbulluar në Perëndim për shumë vite ta sjellim në Kosovë. Ne në Gjermani kemi një biznes të ndërtimit mjaft të suksesshëm investimi në Kosovë do të ndikonte në rritjen ekonomike në rritjen e zhvillimit si dhe sadopak në uljen e papunësisë . Investimi do të bëhet në disa faza dhe burimet e financimit janë në mënyrë vetanake d.m.th. pa ndonjë kredi apo hua nga Bankat. Duke parë që në Kosovë vazhdimisht po ndërtohet e kemi parë të arsyeshme që të fillojmë me prodhimin e

elementeve të parafabrikuara të betonit të armuar të cilat së fund janë bërë të domosdoshme në sektorin e ndërtimit pasi që do të kursejnë kohën si dhe janë shumë më kualitative, Betoniera për prodhimin e Betonit të lëngët. Gjithashtu si pjesë përbërëse e biznesit mendojmë të jete edhe një Autolarje Automatike me një teknologji moderne e bashkangjitur me të do të jetë edhe një Hotel Restorant luksoz.

Biznesi punë primare do ta ketë :

Prodhimin e Elementeve të parafabrikuara të betonit të armuar për ndërtimin e objekteve
Betoniera për prodhimin e betonit të lëngët për ndërtim.

Punë sekondare :

Autolarje Automatike

Punë të tjera:

Objekti i Hotelit-Restauronte dhe Administrata

Konsumatorët tipik për blerjen e pllakave të betonit janë Bizneset Ndërtimore të cilat merren me ndërtimet banesore dhe jo banesore/ Në auto larje konsumator synojmë të argëtojmë institucionet private dhe shtetërore gjithashtu edhe personal fizik / E njëjta strategji do të jetë edhe te hoteleria

Prodhimin e Elementeve të parafabrikuara të betonit të armuar për ndërtimin e objekteve në tregun Kosovar nuk kemi konkurrencë pasi deri më tani nuk ka biznese që merren me këtë prodhim ku ky fakt mendojmë se do të jetë mjaft i volitshëm për biznesin tonë , gjithashtu synim bazik do të jetë futja në treg me cilësi të lartë dhe me punë profesionale.

Sektori

Biznesi jonë bënë pjesë në sektorin e prodhimit si punë primare gjithashtu do të përfshihet sektori shërbimeve dhe sektori i hotelerisë. Ndërtimi është sektor në rritje, dhe si prodhues të vetëm në vend të këtij Lloji jemi të favorizuar, gjithashtu biznesi jonë nuk do të preket nga trendët se zonale .

Produkti/shërbimet

Prodhimi i elementeve të parafabrikuara të betonit të armuar përfshihen :

Prodhimi i shkallëve të gatshme për montim
Prodhimi i pllakave të betonit për ndërtim të objekteve
Prodhimi i frarëve të betonit për ndërtim të objekteve
Mure dekorative për parqe dhe pengesa

Autolarje Automatike përfshihen :

Pastrim i jashtëm i makinave
Pastrim i jashtëm i mjeteve të rënda motorike
Pastrim komplet i makinave
Pastrim komplet i mjeteve të rënda motorike

Hotel dhe Restorant Përfshihen:

Administrata e kompanisë
Dhoma pushimi për akomodim
Dhoma gjumi për akomodim
Shërbim i ushqimit dhe pijeve

Struktura e pronësisë së biznesit

Biznesi do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shkurtimisht SH.P.K. me pronar të vetëm të aksioneve 100% Menaxheri i Biznesit do të raportojë direkt pronarit të Biznesit pasi që nuk mendojmë se do të ketë bord të drejtorëve

Resurset njerëzore

Niveli i të punësuarve do të jetë nga Menaxher i Lartë , Menaxher i Njësive të Biznesit/ Inxhinier/ Punëtorë teknik/

Shankist / Kuzhinier / Kamerier/ Sigurim.

Puna do të kryhet me dy ndërrime / Punëtoveve përveç trustit pensional do tu paguhet edhe sigurimi

KONSTATIM

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit plani i biznesit dhe lidhje me procesverbalin i mbajtur në teren konstatuam se ofertuesi nuk i'u ka përmbajtur planit të biznesit në as një pikë të përshkruar në plan të biznesit dhe as që ka të bëjë veprimtaria e ofruar me gjendjen reale në teren, ofertuesi ka ofruar biznes prodhues për material-produkte betoni të cilat duhen të eksportoreshin në vendet e BE-së mirëpo pas inspektimit nuk kemi parë as një produkt prodhimi të betonit të cilat përshkruhen në plan të biznesit, përveç prodhimit të betonit të lëngët.

• VLERA E INVESTIMEVE – përshkrimi sipas ofertës

Biznesi sipas ofertës ka ofertuar një vlerë prej 1,150,000.00 euro të përshkruar te plani investiv si më poshtë (shiko Figurën 2)




Figura 2 – Plan i investimit sipas ofertës

KONSTATIM

Komisioni gjatë inspektimit në teren ka kërkuar dëshmi lidhje me investimin e bërë në parcelën mirëpo përgjegjësi nuk na ka ofruar as një dokumentacion lidhje me investimet e bëra andaj ne nuk kemi ndonjë dëshmi se sa është investuar në atë parcelë e cila është dhënë për shfrytëzim.

NUMRI I TË PUNËSUARËVE – përshkrimi sipas ofertës

Biznesi sipas ofertës ka ofertuar një numër të konsiderueshëm të punëtorëve që sipas planit të biznesit janë si më poshtë: (shiko Figurën numër 3).

Titulli	Përshkrimi i punës	Numri i punëtorëve		
		Numri i punëtorëve të punësuar	Numri i punëtorëve të punësuar	Numri i punëtorëve të punësuar
Menaxher i Përgjithshëm	001 - plotë	1	1	1
Menaxher i Prodhimit	002 - plotë	1	1	1
Menaxher i Autolarisë	003 - plotë	1	1	1
Menaxher i Hotelit & Restorantit	004 - plotë	1	1	1
Veprimtar	005 - plotë	7	7	7
Punëtor në prodhim	006 - plotë	20	20	40
Punëtor në Autolarie	007 - plotë	6	10	15
Receptier	008 - plotë	2	2	3
Shërbues	009 - plotë	2	2	3
Kamioner	010 - plotë	4	8	12
Sigurues	011 - plotë	1	2	6
Totali		45	65	93

Figura 3 – Numri i të punësuarëve sipas ofertës

KONSTATIM

Komisioni gjatë inspektimit në teren ka kërkuar dëshmimi në lidhje me numrin e të punësuarëve të bërë sipas kontratës mirëpo përgjegjësi nuk na ka ofruar as një dokumentacion lidhje me numrin e të punësuarëve, kemi insistuar të kemi kontratat e të punësuarëve sipas përgjegjësit që na deklaroi që janë 7 punëtor të punësuar, sipas deklaramit të zyrtarit përgjegjës të kompanisë GERMAN BETON SHPK. Pra ofruesi nuk ka punësuar punëtorë sipas planit të biznesit as në vitin fillestar, as në vitin e parë e as në vitin e dytë.

LEJA NDËRTIMORE - e përshkruar në lejën e dhënë vetëm për objektin e fabrikës.
Përshkrimi teknik i projektit për fabrikën e betonit.

Në bazë të detyrës projektuese dhe kërkesës së investitorit është projektuar objekti i fabrikës për prodhimin e betonit.

Lokacioni - Fabrika ndodhet në zonën kadastrale të Kaçanikut me numër të parcelës 1407-0, në fshatin Kaçanik i Vjetër. Ky lokacion është i përshatshëm për zhvillimin e kësaj veprimtarie i cili ka qasje nga rruga kryesore për në Kaçanik të vjetër si dhe rruga Çardaqu e cila e përshkon të gjithë zonën, rrugë kjo e cila e lehtëson qarkullimin në këtë zonë.

Topografia e terrenit është me një pjerrësi të konsiderueshme e cila shtrihet nga pjesa Lindje - Perëndim. Ky terren ka ndikuar edhe në zgjedhjen e lokacionit për pozicionimin e fabrikës, ku është munduar të shfrytëzohet ky terren në favor të investitorit dhe projektit duke kursyer materiale të betonit dhe armaturës si dhe heqja e një sasive sa më të vogël të dheut, përveç kësaj ky pozicion ka krijuar një qasje shumë të mirë për makineritë të cilat do të punojnë

Komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhëmen në shfrytëzim të pronës së pabujshme të komunës sipas planit dinamik realizues

aty si dhe qasja e tyre me rrugën kryesore. Funkzioni - Funkzioni i objektit është për prodhimin e betonit kualitativ e cila do t'i plotësojë të gjitha nevojat e tregut në vend. Fabrika është e përbërë në disa pjesë të cilat janë të lidhura njëra me tjetrën të cilat bëjnë të mundur prodhimin e betonit. Në fillim të fabrikës gjendet pjesa e siloseve të cilat shërbejnë për deponimin e çimentos, pas kësaj vjen pika e derdhjes së betonit ku në këtë pozicionim bëhet edhe ngarkimi i mikserëve të betonit. Në këtë pikë lidhen tubi i cili furnizon mikserin me çimenton dhe tubi tjetër i cili sjell zhavorrin nga pjesa e bunkerëve të cilët i kanë të klasifikuar klasat e agregatëve. I gjithë ky proces monitorohet nga kabina e cila gjendet mes siloseve dhe pikës së furnizimit. Konstruksioni i fabrikës është i përbërë kryesisht nga dy materiale kryesore nga ai metalik si dhe konstruksionit beton arme. Pjesa e makinerisë e cila funksionon për prodhimin e betonit si dhe pjesët e tjera përcjellëse janë të përbërë nga konstruksioni metalik. Ndërsa bazamenti i tyre është i përbërë nga konstruksioni beton arme i cili krijon një stabilitet të madh strukturës metalike dhe krijon në Fabrikë Funktionale si nga ana e strukturës ashtu edhe nga ana e procesit të punës. Themelet e betonit janë të ndara njëra nga tjetra të cilat janë të vendosura në akset e shtyllave metalike.

Vendimi i lejës ndërtimore.

Leja ndërtimore me nr të protokollit 06.nr..351/02-22162/20 e datës 05.11.2020 e lëshuar në emër të personit juridik që figuron me emrin tregtar M&V Group Sh.P.K me adres në Kaçanik të Vjetër, rruga "Komandant Bardhi" në Zonën Kadastrale Kaçanik i vjetër, me llojin e ndërtimit, ndërtim i Ri, kategoria e ndërtimit të II-të dhe me propozim të përdorimit si objekt industrial – fabrikë e prodhimit të betonit.

Më poshtë shiko figurën 4,5, 14,15,16,17,18,19,20,21




Figura 4 – Situacioni i objektit në parcelën ndërtimore nr.1407-0




Figura 5 – Projekti i objektit në parcelën ndërtimore nr.1407-0, në pamjen A

KONSTATIM


Komisioni gjatë inspektimit në teren ka kërkuar dëshmi lidhje me leje ndërtimore për fabrikën për prodhimin e produkteve të betonit, lejen për Restaurant – hotelin , lejen për autolarje mirëpo nga përgjegjësi nuk na ka ofruar as një leje ndërtimore në kontestin se nuk është në dëjani dhe nuk e dinë a ka leje ndërtimore apo jo.

Ne si komision kemi bërë kërkesë me emal zyrtar lidhur me lejet ndërtimore të parcelës 1407-0, ne ZK, Kaçanik i Vjetër, nga sektori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe na kanë ofruar dokumentacionin e kërkuar vetëm Leja ndërtimore me nr te protokollit 06.nr.351/02-22162/20 e datës 05.11.2020 e lëshuar në emër të personit juridik që figuron me emrin tregtar M&V Group Sh.P.K me adresë në Kaçanik të Vjetër, rruga “Komandant Bardhi” në Zonën Kadastrale Kaçanik i vjetër, me llojin e ndërtimit, ndërtim i Ri, kategoria e ndërtimit te II-të dhe me propozim të përdorimit si objekt industrial – fabrikë e prodhimit të betonit. Mirëpo sa i përket lejes për Restaurant dhe për Autolarje nuk figurojnë që posedojnë leje ndërtimore dhe ne si Komision konstatojmë që objekti i ndërtuar është pa leje ndërtimore dhe me poshtë shiko fig. 6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21

• **PROJEKTI IDEOR**

KONSTATIM

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit Projektit Ideor në lidhje me procesverbalin i mbajtur në teren konstatuam se ofertuesi nuk i është përmbajtur Projektit Ideor të përshkruara në ofertë dhe se gjatë inspektimit konstatuam se ofertuesi nuk e shfrytëzon të gjithë hapësirën e kërkuar të pronës. shiko fig. 5,6,7,8,9, 18,19,20,21,22




Figurë 8: OBJEKTI NË PJESËN E BRENDSHME (ZYRE).

Komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dëgjues të shfrytëzimit të pronës së publike dhe të promovimit të punës së publikimit të Komitit të përbashkët dinamik të realitetit




Figurë 12: OBJEKTI NË PJESËN E BRENDSHME –(RESTORANTI)



Figurë 13: OBJEKTI NË PJESËN E BRENDSHME –(RESTORANTI)

Komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave të kontratave të blerjes së shërbimeve të punës së përbashkët të Komunitetit lokal dhe bashkëpunimit



Figurë 16: OBJEKTI NË PJESËN E JASHTME – (REZERVARËT E MBETJES – FEKALE)



Figurë 17: OBJEKTI NË PJESËN E JASHTME – (REZERVARËT E MBETJES – FEKALE)

Kontrasti për mbikëqyrtjen e reaktimit të kontabilitetit për shërbimet në shërbime të punës së përbashkët në Komunën e Prishtinës dhe Komunës së Prishtinës




Figure 18: PAMJE EKZISTUESE E HAPËSIRËS SË PRONËS SË PA SHFRYTËZUESHME

Konkludon për adaptimin e realitimit të korrutave për dhënien në shprehim të pronës së paluajtshme të kontonës sipas planit dinamik realizues



FIGURË 19: PAMJE EKZISTUESE E HAPËSIRËS SË PRONËS TË PA SHFRYTËZUESHME.



FIGURË 20: PAMJE EKZISTUESE E HAPËSIRËS SË PRONËS TË PA SHFRYTËZUESHME.

Komisioni për mbledhjet e realizimit të kontratave për dhënie në shpirtësim të pronës së palëvizshme të komunitetit sipas planit afatshortë realizues





Figure 21: PANJE EKZISTUESE E HAPËSIRËS SË PRONËS TË PA SHFRYTËZUESHME

Komiteti për mbledhjet e realizimit të kumtimit për dhonien e pronës së përbashkët të komunitetit pas planit dokumentar



Figurë 22: PAMJE EKZISTUESE TË AUTOMJETËVE

Komiteti për mbledhjen e realizimit të detyrës për llogaritjen e shifrave të pajisjeve të automjeteve sipas planit dinamik realizues




Figure 23: PAMJE E PRODHIMIT TË BETONIT TË LËNGJET.

Komisioni për mbikëqerjen e realizimit të kontratave për dhënie të shërbimeve të prodhimit të betonit të pranisë në pajisjet dhe të komponentëve të pajisjeve të montuara nga kompanitë dinamikisht realizues




Figure 24 – Projekti i objekti sipas ofertës.

Komisioni për mbledhjen e rrethimit të komiteteve për diskutim në afërsisht të përafshme të punës, w Paballimë të Komitetit sipas planit dinamik vehturs

KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E REALIZIMIT TE KONTRATAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT SIPAS PLANIT DINAMIK REALIZUES BJEN KËTË

PËRFUNDIM

Komisioni ka filluar punën me datë 30 dhjetor 2022 dhe ka përfunduar më : 21.03.2023. Gjithsejtë ka mbajtur 20 takime për shqyrtimin e lëndëve, duke përfshirë këtu edhe vizita në lokalitete të ndryshme në territorin e pronave të dhënies në shfrytëzim të Komunës për të marrë informacione sipas nevojës lidhur me rezultatet për realizimin e kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së komunës.

Komisioni, gjatë procesit të shqyrtimit të lëndëve të paraqitura nga ana e palëve, si dhe inspektimin lidhur me punën e realizuar sipas kontratës , planit dinamik realizues, planit të biznesit, projekti ideor, komisioni punën e saj e mbështeti sipas ligjit nr.06/1-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të datës 10 gusht 2020, dhe vendimi për formimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues 01nr.104/02-31608/2022, te datës 29.11.2022, Plotësimi Vendimi i datës 27.01.2023 dhe në secilën pikë ka konstatuar lidhur me mos realizimin e planit dinamik realizues , kontratën, dhe dokumentet tjera përcjellëse siç janë të përcaktuara me rregullore dhe ligj. Janë të konstatuar mos realizimi i Kontratave.

REKOMANDIME për Kryetarin e Komunës së Kaçanikut që:

Te filloj procedurën e mbikëqyrjes se kontratës sipas ligjit nr.06/1-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të datës 10 gusht 2020 në pikat si më poshtë:

Neni 22 i ligjit nr.06/1-092

Mbikëqyrja e kontratave

1. Komuna mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues.
2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.
3. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.
4. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit

Neni 27 i Rregullores (QRK) nr. 09/2020

Mbikëqyrja e kontratave

Komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues

1. Drejtoria përkatëse e komunës mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Drejtoria harton raportin për ecurinë e zbatimit të planit dinamik si dhe realizimin e kontratës si tërësi, duke i rekomanduar kryetarit të komunës marrjen e masave përkatëse në rast të mos përmbushjes së kontratës.
3. Kryetari i komunës pas shqyrtimit të raportit merr masave përkatëse ndaj investitorit më qëllim të përmbushjes së kontratës.
4. Nëse investitori edhe pas masave të shqiptuara nuk ndërmer veprime për realizimin e kontratës, kryetari i komunës obligohet të njoftoj kuvendin e komunës së bashku me rekomandimin për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.
5. Kuvendi i komunës, pas njoftimit të pranuar nga kryetari, shfuqizon vendimin përkatës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.
6. Pas shfuqizimit të vendimit të kuvendit të komunës, kryetari i komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

KONKLUDIMI I PËRGJITHSHËM:

Komisioni ka ardhuri në konkludim të përgjithshëm duke ju referuar konstatimeve të lartëcekura se investitori nuk i ka përmbushur zotimet e tij sipas kontratës dhe detyrimeve të tij për marrje në shfrytëzim afatgjatë të parcelës komunale për zhvillim të biznesit.

Të bashkangjitur këtij Raport janë edhe dokumentet si më poshtë:

- Kontrata për për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës me nr. të protokollit kontratës 01-104/02-39284/2019, të datës 12.12.2019 e lidhur me Komunën e Kaçanikut,
- Oferta e aplikimit me nr. Të protokollit 01nr.104/02-15826/2019 të datës 29.05.2019
- Plani dinamik investiv
- Plani i biznesit
- Projekti ideor
- Leja ndërtimore
- Leja mjeditsore komunale.
- Dokumentet e regjistrimit të bizneseve

Me këtë Raport njoftohen:

Kryetari i Komunës, Drejtorja e Urbanizmit, Kudostrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Arkivi.

Kaçanik
Datë 21.03.2023

Komisioni Mblkëqyrës

1. Besmir Krasniqi Kryesues ; _____
2. Edmond Mjaku anëtar ; _____
3. Festim Neziraj anëtar ; _____
4. Agron Dema anëtar ; _____
5. Jeton Topalli anëtar ; _____

Komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik – Municipality Kaçanik



ZYRA E KRYETARIT

nr. 104/02-9816/23
Datë 26.04.2023

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2, shkronja (d) dhe nenit 17, shkronja (e) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), si dhe të nenit 6 paragrafi 1, 2 dhe shkronja (h) dhe (q) të Statusit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statusit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të ligjit ligji nr. 06/1-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Neni 22, si dhe rregullore (qrk) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 27 pika 3, Kryetari i Komunës, me datën 26.04.2023 nxjerr këtë :


NJOFTIM

- I. Duke ju referuar Rekomandimit të komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues 01nr.104/02-31608/2022, të datës 29.11.2022, si dhe duke u bazuar në konstatimet e dhëna në Raportin e komisionit me nr. protokollit 01-04/02-7153/2023 të datës 21.03.2023, që në konkludimin e përgjithshëm ka konstatuar se investitori nuk i ka përmbushur zotimet e tija sipas kontratës dhe detyrimet të tij për marrje në shfrytëzim afatgjata të parcelës komunale për zhvillim ekonomik.
Andaj kryetari në bazë të nenit 27 pika 3 ku thuhet Kryetari i komunës pas shqyrtimit të raportit merr masave përkatëse ndaj investitorit më qëllim të përmbushjes së kontratës, andaj në bazë të ligjit dhe rregullores kryetari nxjerr këtë njoftim.
- II. Njoftohet ofertuesi z. Mevlud Zharku i lindur më datë 21.11.1984, Nr. personal; 1500027319, ID 0423468 e lëshuar me datë 26.11.2015 nga MPB-Republika e Kosovës që në afat prej 3 muaj shtesë të bëjë realizimin e kontratës e cila kontratë është nënshkruar me datën 12 Dhjetor 2019, dhe në bazë të rekomandimit të cekur në konstatime duhet të përmbushen të gjitha pikat e cekura sipas kontratës , planit të biznesit , planit dinamik dhe numrit të punësuarëve , sipas afatit prej 3 muaj, nëse brenda 3 muajve nuk është bërë realizimi i kontratës dhe detyrimet e tij, kryetari do të veprojë sipas ligjit dhe rregullores.

Sipas njoftimit të lartcekur, lidhur me shtyrjen shtesë të afatit prej 3 muaj propozohet si dispozitiv të këtij njoftimi.

Te bashkangjitur gjeni edhe raportin të komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik.

Kryetari i Komunës
Besfim Ilazi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik / Municipality of Kačanik



Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Në mbështetje të Njoftimit 01Nr.104/02-9816/2023 të datës 26.04.2023 për shtyrjen shtesë të afatit prej 3 muaj që ka të bëjë me realizimin e kontratës dhe rekomandimit të cekur në raportin 01Nr.104/02-7153/2023, përpilon këtë:

RAPORT

Duke ju referuar Njoftimit 01Nr.104/02-9816/2023 të datës 26.04.2023 për shtyrjen shtesë të afatit prej 3 muaj që ka të bëjë me realizimin e kontratës dhe rekomandimit të cekur në raportin 01Nr.104/02-7153/2023 për ofertuesi z. Mevlud Zharku i lindur më datë 21.11.1984, Nr. personal; 1500027319, ID 0423468 e lëshuar me datë 26.11.2015 nga MPB-Republika e Kosovës

Gjatë inspektimit të punës është bërë kontrollimin sipas Njoftimit 104/02-9804/2023 të datës 26.04.2023 që ka të bëjë për shtyrjen shtesë të afatit prej 3 muaj për me realizimin e kontratës dhe rekomandimit të cekur në raportin 01Nr.104/02-7148/2023 për ofertuesin z. Mevlud Zharku

- I. Konstatohet se investitori nuk i ka përmbushur zotimet e tija sipas kontratës dhe detyrimet të tij për marrje në shfrytëzim afatgjat të parcelës komunale për zhvillim ekonomik dhe se i nijeti nuk ka bërë ndryshime lidhje me investime në objekt, dhe se gjendja është e njëjtë si në raportin 01Nr.104/02-7153/2023, të datës 21.03.2023.

Me këtë Raport njoftohen:

Kryetari i Komunës,

Kaçanik
Datë 18.10.2023

Zyrtari për çështje pronësore
z. Besmir Krasniqi

Drejtori I DUKMM-së
z. Qamil Stagova



Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, Kačanik 71000, Kosovë



01.Nr. 104/02-11633/24
Datë 17.05.2024

Në mbështetje të nenit 58, shkronja (h) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), si dhe të nenit 22 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 27, të rregullore (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6 pika 2 shkronja (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës të merre këtë :

PROPOZIM VENDIM PËR SHKËPUTJE TË KONTRATËS Me nr protokollit 104/02-8678/2021 të datës 22.03.2021

1. Kuvendit të komunës për miratim të vendimit për shkëputje të kontratës për dhënen në shfrytëzim afatgjate të pronës së paluajtshme të komunës E lidhur në Komunën e Kaçanikut me 22 Mars 2021 ndërmjet: Komuna e Kaçanikut, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe "KAÇINKA" L.L.C e regjistruar në zyrën e bizneseve në Kaçanik, me NRB. 81138429, me adresë në fsh. Kaçanik i Vjetër, Rruga Komandant Bardhi, pn, e përfaqësuar nga Jetmir Shehu, E gjeni të bashkangjitur si dokument shtesë, (Kontratën).

Arsyetim

Propozimi për iniciimin për shkeputje te Kontrates se lartecekur behet duke u bazuar ne raportin per mbikqyrjen e realizmit te kontrateve per dhenien ne shfrytezim te prones se paluajtshme te Komunes se Kacanikut, sipas planit dinamik ralizues me nr. 01/104/02-7148/2023, te dates 21.03.2023, Njoftimin e dates 26.03.2023, raportit te dates 18.10.2023.

Investitori nuk i ka përmbushur zotimet e tija sipas kontratës dhe detyrimet të tij për marrje në shfrytëzim afatgjat të parcelës komunale për zhvillim ekonomik dhe i nijeti nuk e ka realizuar planin dinamik realizuaes, planin e biznesir, projektin ideor.

Të bashkangjitura i gjeni si dëshmi:

- Kontrata me nr protokollit 104/02-8678/2021 të datës 22.03.2021
- Raportin per mbikqyrjen e realizmit te kontrateve per dhenien ne shfrytezim te prones se paluajtshme te Komunes se Kacanikut, sipas planit dinamik ralizues me nr. 01/104/02-7148/2023, te dates 21.03.2023,
- Njoftimin e dates 26.03.2023 dhe raportit te dates 18.10.2023.

Nga të theksuarit si më lartë u propozua për miratim si në dispozitiv të këtij Propozim – Vendimi

Drejtori I DUKMM-së
z. Qamil Stagova



Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

Titulli	21.03.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. origj.	Numri	Shtojce	
01	104/02-8678	✓	

**KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E REALIZIMIT TË KONTRATAVE PËR DHËNIEN
NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË
KOMUNËS SË KAÇANIKUT SIPAS PLANIT DINAMIK REALIZUES**

Në mbështetje të Vendimit për formimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues 01nr.104/02-31608/2022, të datës 29.11.2022, Plotësimi Vendimi i datës 27.01.2023 si dhe në bazë të kontratës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së komunës nr.01-104/02-8678/2021 e lidhur me datën 22.03.2021, në parcelën kadastrale P-709170086-00402-0 dhe P-70917085-00403-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues përpilon këtë:

RAPORT

Duke ju referuar Vendimit për formimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues 01nr.104/02-31608/2022, të datës 29.11.2022, si dhe Plotësimi Vendimi i datës 27.01.2023, dhe duke u bazuar në nenin 9 të kontratës pika 9.1 dhe 9.2 e cila ka të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik me nr. 01-104/02-8006/2021, të datës 15.03.2021, komisioni në përbërje të plotë doli nëpër lokacione me qëllim të verifikimit dhe regjistrimit të punimeve duke u bazuar në planin dinamik realizues.

Gjatë punës nëpër teren kemi hasur në vështirësi për shkak të natyrave të ndryshme të punës, kushteve atmosferike, koha e shkurtër e regjistrimit por në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të institucioneve të ndryshme kemi arritur që të bëhet puna efektive.

Komisioni gjatë punës ka bërë mbikëqyrjen e kontratës të "KAÇINKA" L.L.C me nr. të kontratës 01-104/02-8678/2021, të datës 22.03.2021 e lidhur me Komunën e Kaçanikut, kontrata për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për 40 vite është nënshkruar nga të dy palët e cila pronë gjendet në parcelat kadastrale P-709170086-00402-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me sipërfaqe të aprovuar 00.95.48 ha, dhe në parcelën kadastrale dhe P-70917085-00403-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me sipërfaqe të aprovuar 00.32.99 ha.

Duke u bazuar në nenin 9 të kontratës pika 9.1 dhe 9.2 e cila ka të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik, komisioni ka dalur në vendin e quajtur Gllavica në zonën kadastrale Kaçanik i Vjetër, ofertuesi ekonomik "KAÇINKA" L.L.C dhe ka mbajtur procesverbal mbi inspektimet e kryera dhe në të cilën janë përshkruar shënimet e përgjithshme për subjektin e inspektuar, përshkrimi i kontrollimit, Dokumentacioni, përshkrimi i objektit, vendit të inspektuar dhe konstatimin, andaj komisioni duke u bazuar në kontratën për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për 40 vite e cila është nënshkruar nga të dy palët, si dhe procesverbali i datës 13.02.2023 bëjnë përshkrimin e këtij raporti duke u bazuar në pikat si më poshtë:

1. Kontrata
2. Shënimet aktuale për subjektin e inspektuar
3. Përshkrimi i kontrollimit
4. Dokumentacioni
5. Përshkrimi i objektit të vendit të inspektuar dhe
6. Konstatimin

Gjatë përshkrimit të pikave si më lart do të përshkruhet gjendja faktike me gjendjen e ofertuar nga ofertuesi dhe në fund të çdo pikë do të bëhet konstatimi i gjendjes reale me atë të ofertuar dhe shkëlja e nenëve të kontratës.

1. KONTRATA
KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

E lidhur në Komunën e Kaçanikut me 22 Mars 2021 ndërmjet: Komuna e Kaçanikut, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe "KAÇINKA" L.L.C e regjistruar në zyrën e bizneseve në Kaçanik, me NRB. 81138429, me adresë në fsh. Kaçanik i Vjetër, Rruga Komandant Bardhi, pn, e përfaqësuar nga Jetmir Shehu, E gjeni të bashkangjitur si dokument shtesë, (Kontratën).

2. SHËNIMET AKTUALE PËR SUBJEKTIN E INSPEKTUAR

Shënime të përgjithshme për subjektin e inspektuar në teren:	
Emri i subjektit të inspektuar	"KAÇINKA" L.L.C
Personit përgjegjës	-----
Emri i Personit Fizik (pronarit).	JETMIR SHEHU
Adresa	fsh. Kaçanik i Vjetër, Rruga Komandant Bardhi, pn
Komuna	KAÇANIK
Numri i regjistrimit të biznesit	81138429
Lloji i Veprimtarisë	OBJEKTI PËR PRODHIMIN E MURËVE PARAFABRIKUAR
Numri kontaktues	046/158-858
Legjislacioni i aplikuar në këtë inspektim.	Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr. 06/L-092: Rregullore (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

KONSTATIM

Gjatë inspektimit në vendin e ngjarjes janë kërkuar dokumentet e nevojshme lidhur me qarkullimin e biznesit dhe për të cilën në kemi kërkuar sipas kontratës, personi përgjegjës – pronari nuk na ka ofruar dokumentet e nevojshme dhe ndërkohë do t'i përcjellim çdo dokumentacion që ju kërkon. Gjatë inspektimit vërejtëm se po në këtë pronë nuk është themeluar biznesi "KAÇINKA" L.L.C e regjistruar në zyrën e bizneseve në Kaçanik, me NRB. 81138429, me adresë në fsh. Kaçanik i Vjetër, Rruga Komandant Bardhi, pn, e përfaqësuar nga Jetmir Shehu, nuk është duke funksionuar sipas ofertes me të cilën ka fituar pronën në shfrytëzim ngase nuk ka filluar akoma me ndërtimin e objektit, mirëpo ofertuesi është duke vepruar – qarkulluar me veprimtari në një objekt tjetër të cilën është me qira nga ofertuesi deri në rregullimin e infrastrukturës- objektit sipas projektit-ofertes.

(Të bashkangjitur gjeni raportin e investimeve, fletëpagesat dhe kontrata e qerasë nga ofertuesi si dhe një informacion mbi gjendjen e zhvillimit të kompanisë).

2. PËRSHKRIMI I KONTROLLIMIT.

Gjatë inspektimit ne kemi bërë kontrollimin e dokumentacioneve duke u bazuar në ofertën me të cilën ofertuesi ka fituar pronën në shfrytëzim për 40 vite , si dhe kontratën e cila është lidhur me datën 22.03.2021.

DOKUMENTACIONET E KONTROLLUARA

- PLANI DINAMIK INVESTIV
- PLANI I BIZNESIT
- PROJEKTI IDEOR
- VLERAT E INVESTIMEVE
- NUMRI I TE PUNËSUARËVE
- LEJA NDËRTIMORE
- LEJA MJEDISORE KOMUNALE .

- **PLANI DINAMIK INVESTIV – përshkrimi sipas ofertës**

Sipas ofertuesit plani dinamik investiv ka qenë i realizueshëm siç ka kërkuar ofertuesi të jetë në dy faza të cilat faza kanë qenë për të përfunduara brenda një viti.

Përshkrimi i punëve në Fazën e parë -I-

- 1 Projekti ideor ,
1. Pastrimi i terrenit,
2. Fillimi i punës,
3. Heqja e dheut dhe rrafshimi
4. Vendosija e rrethojave, të gjitha këto i duhet të përfundojnë në vitin e parë.

- Në fazën e parë punët e realizuara sipas inspektimit, janë përfunduar të gjitha punët sipas planit dinamik realizues të cilën ka kërkuar ofertuesi.

Përshkrimi i punëve në Fazën e dytë -II-

- 1 Fillimi i punëve në themel,
- 2 Përgatitja e sallës për prodhim,
- 3 Ardhja e makinave të punës,
- 4 Fillimi i prodhimit . të gjitha këto i duhet të përfundojnë në vitin e dytë .

- Në fazën e dytë punët e realizuara sipas inspektimit janë përfunduar vetëm pika 3, 4 ndërsa pika 1 dhe 2 nuk kanë filluar akoma nga ofertuesi .

KONSTATIM

Në Fazën e parë gjatë inspektimit lidhur me planin dinamik investiv, me të cilin ka aplikuar ofertuesi, përshkrimi i cili është bërë që të jetë si në ofertën me të cilin ka aplikuar përputhet në të gjitha fazat si edhe hapësira brenda siç ka kërkuar ofertuesi;

- Projekti ideor ,(është bërë sipas planit dinamik)
- Pastrimi i terrenit ,(është bërë sipas planit dinamik)Fillimi i punës,
- Heqja e dheut dhe rrafshimi ,(është bërë sipas planit dinamik)
- Vendosija e rrethojave, ,(është bërë sipas planit dinamik)
- Fillimi i punëve në themel,(nuk është bërë sipas planit dinamik)
- Përgatitja e sallës për prodhim,(nuk është bërë sipas planit dinamik)
- Ardhja e makinave të punës, ,(është bërë sipas planit dinamik)mirëpo funksionon në objektin me qira.;
- Fillimi i prodhimit ,(është bërë sipas planit dinamik)mirëpo funksionon në objektin me qira.;

Në përfundim komisioni konstaton se gjatë kontrollimit të dokumentacionit dhe daljes në teren për verifikim sipas planit dinamik realizues, ofertuesi nuk i ka plotësuar të gjitha pikat e planit dinamik sipas përshkrimit të ofertuar në pikat e cekura si më lartë, andaj ne si komision konkludojmë që plani dinamik nuk është realizuar sipas ofertës për të cilin ka fituar pronën dhe nga plani dinamik koha e investimit ka qenë 2 vite, dhe se përgjegjësi konstaton në procesverbal se punimet për ndërtimin e objektit do të fillojnë në vitin 2023.

(Të bashkangjitur gjenden raportin e investimeve, sletëpagesat dhe kontrata e qerasë nga ofertuesi si dhe një informacion mbi gjendjen e zhvillimit të kompanisë).

Komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së pabujtshme të komunës sipas planit dinamik realizues




Figura 1 (Plani dinamik realizues sipas ofertës faza I dhe II).




Figura 2 (Plani dinamik realizues sipas ofertës faza I).

Planifikimi dinamik II

Fillimi i Prodhimit

- Zhvillimi në dy faza
- Faza e parë: Fillimi i prodhimit ne nje salle të jashtme
 - Marrja me qira e një salle tjetër deri në 24 muaj nga Dhjetori 2020
 - Fillimi i aktivitetit te prodhimit Qereku I 2021
 - Në 2020 kalojmë në parcelë tonë (të marrun në shfrytëzim nga komuna)
- Faza e dytë: Vazhdimi i prodhimit me intenzitet në pronën tonë
 - Pas kësaj vazhdimi dhe zgjerimi i aktiviteteve operacionale në varsi të zhvillimit ,ndërtimit të një salle të II-të mundë të jetë i nevojshëm në të njejtën parcelë (vëllimi i ndërtimit ndërmjet 1.500-3.000 m2)

Figura 3 (Plani dinamik realizues sipas ofertës faza II).

1. PLANI I BIZNESIT – përsëkrimi sipas ofertës

Emri i Biznesit: " KAÇINKA LLC ", me nr. biznesi: 811389429

QËLLIMI I KORPORATËS

Prodhimi i konstruksioneve dhe komponentëve të parafabrikuara

BAZA E NDËRMARRJES

Ndërtim i qëndrueshëm

Bazuar kryesisht në dru -

Ndërtime inventive -

Zhvillimi i konstruksionit të drurit që kursen burime

Zhvillimi në planifikimi dhe inovativitet (kreativitet)

Produktet e reja do të prodhohen me një qasje inventive dhe me çmime të mira Konkurruese

Çertifikimi i produkteve sipas standardeve evropiane

TRAINIMET (AFATMESËM)

Ne bashkëpunim me institucionet arsimore dhe ndërmarrjet e tjera (shoqata)

Zhvillimi opsional i një profesioni të ri (ndërtimi i mureve të drurit)

FUSHAT E BIZNESIT

Elementet e murit (breada dhe jashtë)

Mure ndarëse për banjo

Kulmet

Strukturat e çatise

Shkallet e brendshme prej druri

Ballkone

PLANIFIKIMI I INDËRTIMIT TË NDËRTESAVE

Planifikimi i zbatimit për projektet ne Gjermani

Zhvillimi konstruktiv i mëturjeshëm | produkteve - individuale në ndërtimin e ndërtesave

Mbrojtje nga zjarri

Mbrojtja nga zhurma

Izolim

Materiale të reja

BURIMET FINANCIARE

Kontributi bazë paguar në shumë 50,000 € Investimi ne pajisjet e reja për fabrike ne 5 vitet e para 350.000€

Komisioni për mbikëqirjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues

Salla e fabrikës / zyra / objektet ndihmëse, ne 5 vitet e para 350.000€

Financimi përmes aksionareve kryesore nga Gjermania, asnjë investim nga kredit bankare

BAZAT EKONOMIKE

Shitja e produkteve në Gjermani (hapi i parë)
Të hyrat nga shitjet e para vlerësuara
Në 5 vitet e ardhshme deri 10 milion €

FILLIMI I PRODHIMIT NGA VITI 2021

Klienti fillimisht aksionari kryesor (fondacioni me pronat e tij) për shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve për portofolin e pronave të veta, pastaj: prodhimi për treg me fokuse për treg te jashtëm: DACH (Gjermani, Austri dhe Zvicër (hapi dytë)

PERSONELI

Planifikimi i personelit për 5 vitet e ardhshme
Rritja e madhe e personelit
Ende për t'u themeluar ne vitin 2020
Struktura e ngjashme e aksionareve
Ndarja e pasurisë së paluajtshme dhe objektit prodhues
Kompania pasurive të paluajtshme L.L.C do të ishte -gjithashtu kërkuesi për ndryshimin e pronësisë për shfrytëzimin e pronës.

NË PRODHIM

zejtare ne te gjitha profesionet për ndërtim
zdrukthëtarë, ndërtues i mureve akustike, elektrikist, zdrukthëtarë të profileve te ndryshme, ngjyrosësh, hidraulik

NË PREGADITJEN E PLANËVE

Arkitekte, inxhinierë ndërtimi, në menaxhim(administrate), kontabilitet, logjistika
Nga fillimi 10 punonjës deri në 20 punonjës
Shumë të varur nga situata e tanishme dhe zhvillimet e tregut
Mundësi trajnimit të mëtutjeshëm
Pozita te trajnimit të nxënësve (afatmesëm)

KONSTATIM

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit plani i biznesit dhe lidhje me procesverbalin i mbajtur në teren konstatuam se ofertuesi i është përmbajtur planit të biznesit mirëpo ky plan biznesi është duke funksionuar në prodhimin siç e ka përshkruar ofertuesi në planin dinamik dhe në plan të biznesit në një objekt me qira dhe për të cilën paguan qiranë me kontratë të cilën ofertuesi e ka dëshmuar, komisioni konstaton qe plani i biznesit është arritur sipas ofertuesi. shiko Figurën 10.

(Të bashkangjitur gjeni raportin e investimeve, fletëpagesat dhe kontrata e qerasë nga ofertuesi si dhe një informacion mbi gjendjen e zhvillimit të kompanisë).

• VLERA E INVESTIMEVE – përshkrimi sipas ofertës

Biznesi sipas ofertës ka ofertuar një vlerë prej 700,000.00 mijë euro të përshkruar në aplikacion si më poshtë (shiko Figurën 4)

3. Vlera e investimeve:	në Euro	700.000,-	Me fjale <i>(shatëz) një mijë euro</i>
--------------------------------	---------	------------------	--

Figura 4- Vlera e investimit sipas aplikacionit të ofertës.

KONSTATIM

Komisioni gjatë inspektimit në teren ka kërkuar dëshmi në lidhje me investimin e bërë në parcelën dhe personi përgjegjës ka ofruar një shënim lidhje me investimet e bëra andaj ne kemi shikuar shënimet dhe analizuar me gjendjen faktike në teren dhe konstatojmë që nuk është arritur vlera e investimeve si në ofertë, mirëpo disa punime janë të përfunduara si heqja - zhvendosja e dhutë dhe sipas procesverbalit për punimet tjera ofertuesi premtan që do të bëhet brenda vitit 2023. Shiko figurën 4

(Të bashkangjitur gjeni raportin e investimeve, fletëpagesat nga ofertuesi si dhe kontratat e qirasë).

Komisioni për mbledhjen e realizimit te kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të kompanisë sipas planit dinamik konstatues

NUMRI I TE PUNËSUARËVE – përshkrimi sipas ofertës

Biznesi sipas ofertës ka ofertuar një numër të konsiderueshëm të punëtorëve që sipas planit të biznesit janë 5 ekzistues ndërsa të propozuar 20 punëtorë : (shiko Figurën numër 5).

2. Numri i vendeve të punës:	
Egzistuese	<input type="text" value="5"/>
Propozuara	<input type="text" value="20"/>

Figura 5 – Shënimet e numrit të punëtorëve sipas aplikacionit të ofertës.

KONSTATIM

Komisioni gjatë inspektimit në teren ka kërkuar dëshmi në lidhje me numrin e të punësuarëve, personi përgjegjës na ka ofruar listën e të punësuarëve dhe në të cilën figuroju 20 punëtorë të regjistruar. Shiko fig. Nr 5

(Të bashkangjitur gjeni raportin e të punësuarëve nga ofertuesi).

LEJA NDERTIMORE -

KONSTATIM

Komisioni gjatë inspektimit në teren ka kërkuar dëshmi në lidhje me lejen ndërtimore, mirëpo përgjegjësi nuk na ka ofruar ndonjë dokument që konstaton se ka leje ndërtimore. Komisioni gjatë shqyrtimit të dokumenteve ka bërë kërkesa me email zyrtar lidhje me leje ndërtimore për ofertuesin "KAÇINKA" LLC e regjistruar në zyrën e bizneseve ne Kaçanik, me NRB. 81138429, me adresë në fsh. Kaçanik i Vjetër. Rruga Komandant Bardhi, pa, e përfaqësuar nga Jetmir Shehu, dhe të njëjtit na kanë konfirmuar se ofertuesi ka bërë kërkesë për ndërrim të distenimit dhe të cilin i është aprovuar vendimi për miratimin e kushteve ndërtimore dhe për leje ndërtimore ofertuesi nuk ju ka përmbajtur kushteve dhe afateve për plotësimin e dokumentacioneve .

Më poshtë shiko figuren 5,6,7,8,9,

• PROJEKTI IDEOR

KONSTATIM

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit Projektit Ideor në lidhje me procesverbalin e mbajtur në teren konstatuam se ofertuesi nuk ka filluar akoma ndërtimin e objektit shiko fig. 7,8,9




Figura 6 – Projekti idear sipas ofertës



Figura 6 – Projekti idear sipas ofertës

Komisioni për mbledhjen e realizimit të konstruksioneve për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dhe realizues





Figura 7 – Projekt i idear sipas ofertës




Figurë 8: PAMJE EKZISTUËSE E HAPËSIRËS SË PRONËS

Komisioni për mbikëqerjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues



Figurë 9: PAMJE EKZISTUESE E HAPËSIRËS SË FRONËS



Figurë 10 : PAMJE EKZISTUESE E OBJEKTIT ME QIRA - PRODHIM

KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E REALIZIMIT TË KONTRATAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT SIPAS PLANIT DINAMIK REALIZUES EJEN KËTË

PËRFUNDIM

Komisioni ka filluar punën me datë 30 dhjetor 2022 dhe ka përfunduar më 21.03.2023 . Gjithsejtë ka mbajtur 20 takime për shqyrtimin e lëndëve, duke përfshirë këtu edhe vizita në lokalitete të ndryshme në territorin e pronave të dhënies në shfrytëzim të Komunës për të marrë informacione sipas nevojës lidhur me rezultatet për realizimin e kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së komunës.

Komisioni, gjatë procesit të shqyrtimit të lëndëve të paraqitura nga ana e palëve, si dhe inspektimin lidhur me punën e realizuar sipas kontratës , planit dinamik realizues, plan biznesit, projekti ideor, komisioni punën e saj e mbështeti sipas ligjit nr.06/l-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të datës 10 gusht 2020, dhe vendimi për formimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues 01nr.104/02-31608/2022, të datës 29.11.2022, dhe në secilën pikë ka konstatuar lidhur me mos realizimin e planit dinamik realizues , kontratën, dhe dokumentet tjera përcjellëse siç janë të përcaktuar me rregullore dhe ligj, Janë të konstatuar mos realizimi i Kontratave.

REKOMANDIME Kryetarit e Komunës së Kaçanikut që:

Të filloj procedurën e mbikëqyrjes së kontratës sipas ligjit nr.06/l-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të datës 10 gusht 2020 ne pikat si më poshtë:

Neni 22 i ligjit nr.06/l-092

Mbikëqyrja e kontratave

1. Komuna mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues.
2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.
3. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.
4. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit

Neni 27 i Rregullores (QRK) nr. 09/2020

Mbikëqyrja e kontratave

1. Drejtorja përkatëse e komunës mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

2. Drejtoria harton raportin për ecurinë e zbatimit të planit dinamik si dhe realizimin e kontratës si tërësi, duke i rekomanduar kryetarit të komunës marrjen e masave përkatëse në rast të mos përmbushjes së kontratës.

3. Kryetari i komunës pas shqyrtimit të raportit merr masave përkatëse ndaj investitorit më qëllim të përmbushjes së kontratës.

4. Nëse investitori edhe pas masave të shqiptuara nuk ndërmer veprime për realizimin e kontratës, kryetari i komunës obligohet të njoftoj kuvendin e komunës së bashku me rekomandimin për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.

5. Kuvendi i komunës, pas njoftimit të pranuar nga kryetari, shfuqizon vendimin përkatës për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim.

6. Pas shfuqizimit të vendimit të kuvendit të komunës, kryetari i komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim.

KONKLUZIMI I PËRGJITHSHËM:

Komisioni ka ordhur në konkludim të përgjithshëm duke ju referuar konstatimeve të lartëcekura se investitori i ka përmbushur pjesërisht tërësit e tija sipas kontratës dhe detyrimeve të tija për marrje në shfrytëzim afatgjatë të parcelës komunale për zhvillim të biznesit.

Të bashkangjitur këtij Raport janë edhe dokumentet si më poshtë:

- *Kontrata për dhënie në shfrytëzim afat gjate të pronës së paluajtshme të Komunës me nr. të protokollit kontratës 01-104/02-8678/2021, të datës 22.03.2021 e lidhur me Komunën e Kaçanikut,*
- *Oferta e aplikimit me nr. Të protokollit 01nr.104/02-20439/2020 të datës 24.08.2020.*
- *Plani dinamik investiv*
- *Plani i biznesit*
- *Projekti ideor*
- *Leja ndërtimore*
- *Dokumentet e regjistrimit të bizneseve, si dhe dokumentet tjera përcjellëse.*


Me këtë Raport njoftohen:

Kryetari i Komunës, Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Arkivi.

Kaçanik


Datë 21.03.2023

Komisioni Mbikëqyrës

1. Besmir Krasniqi Kryesues ; 

2. Edmond Mjaku anëtar ; 

3. Festim Neziraj anëtar ; 

4. Agron Dema anëtar ; 

5. Jeton Topalli anëtar ; 





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KACANIKUT
MUNICIPALITY OF KACANIK



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

22.03.21	KACANIK
105/02-5635	

Në bazë të nenit 14 pika 14.1, 14.2, 14.3 lidhur me nenin 17 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/04 Qershor 2008), të nenit 6 pika 1.2 lidhur me nenin 19 pragrafi 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019, Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.104/02-30658/20 i datës 29.01.2021, Konfirmimi i ligjshmërisë - MAPL-së VI-020-101, datë 15/02/2021, Kryetari i Komunës lidh kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese;

KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

E lidhur në Komunën e Kaçanikut me 22 Mars 2021 ndërmjet:

- 1) Komuna e Kaçanikut, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe
- 2) "KAÇINKA" L.L.C e regjistruar në zyrën e bizneseve, ARBK; 81138429, Adresa: Florim Maliqi, Nr.34 - Ferizaj, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Jetmir Shehu, me Nr. personal; 1171045289, me banim Br."Reshat Shehu"- Kaçanik, në tekstin në vijim "Operatori Ekonomik".

Neni 1.

Lënda e Kontratës:

1.1 Sipas afateve dhe duke ju nënshtruar kushteve të parashtruara në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues i jep në shfrytëzim afatgjatë për 40 (katërdhjetë) vite Operatorit Ekonomik, dhe Operatori Ekonomik marr në shfrytëzim afatgjatë nga Autoriteti Kontraktues, parcelat kadastrale Nr.P-70917086-00402-0, në sipërfaqe 0.95.48 ha dhe parcela kadastrale Nr.70917086-00403-0, në sipërfaqe 0.32.99 ha, me sipërfaqe të përgjithshme 1.28.47 ha, në zonën kadastrale Kaçanik i Vjetër, pronë shoqërore e K.K Kaçanik.

Neni 2.

2.1 Autoriteti Kontraktues është pronar i pronës së paluajtshme komunale të përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, në tekstin në vijim e referuar si "objekti i kontratës".

Neni 3.

E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë.

Neni 4.

4.1 Objekti i kontratës është i paradestinuuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitete afariste të bizneseve, për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal. Operatori Ekonomik do të shfrytëzoj objektin e kontratës për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve prodhuese – ndërtimin e Fabrikës, sipas projekt propozimit të paraqitur tek Autoriteti Kontraktues dhe kushteve të zhvillimit të projektit.

Neni 5.

5.1. Autoriteti Kontraktues pajtohet t'i ofroj çasje të lirë Operatorit Ekonomik në objektin e kësaj kontrate, për tërë periudhën e shfrytëzimit të tij, pa ndërhyrje.

Neni 6.

Objekti i kontratës

6.1. Autoriteti Kontraktues i'a jep në shfrytëzim pronën Operatorit Ekonomik, ndërsa Operatori Ekonomik e merr në shfrytëzim nga Autoriteti Kontraktues objektin e përshkruar si vijon:

6.2. Fleta poseduese

6.3. Parcela

6.4. Madhësia e tokës

6.5. Të dhëna tjera në lidhje me tokën.

Neni 7.

Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm:

7.1. Duke lu nënshtruar edhe afateve të tjera të kësaj Kontrate, kohëzgjatja e kësaj Kontratë për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës është për 40 (katerdhjetë) vite, që fillon të llogaritet nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

7.2. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkalluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

7.3. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmanges nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit.

7.4. Nëse Operatori Ekonomik nuk e plotëson ndonjë kusht paraprak, Autoriteti Kontraktues mund të anulojë këtë Kontratë, duke e njoftuar me shkrim Operatorin Ekonomik për këtë dhe të kërkoj dëmshpërblim sipas dispozitave ligjore në fuqi.

7.5. Operatori Ekonomik ka të drejtë që, në diskrecionin e tij të vetëm dhe të plotë, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, ta anulojë këtë Kontratë para datës së përfundimit të saj pa ndonjë kërkesë për dëmshpërblim, duke e njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktues për synimin e tij për ta anuluar këtë Kontratë. Operatori Ekonomik duhet ta njoftojë Autoritetin Kontraktues me shkrim së paku 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës më të cilën synon ta anulojë këtë Kontratë.

Neni 8.

8.1. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

8.2. Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

8.3. Pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund t'i vazhdohet afati në bazë të performancës.

Neni 9.

Mbikëqyrja e kontratave:

9.1. Komuna mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues të punës.

9.2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe

përbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Neni 10.

10.1 Operatori ekonomik obligohet ti përmbahet vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.104/02-30658/2021 i datës 29.01.2021, si dhe me projektin ofertues nr.01-104/02-20430 të datës 24.08.2020, në rastë të mos përbushjes së tyre Kryetari i Komunës ka të drejtë ta shkëpus kontratën në mënyr të njëanshme.

Neni 11.

11.1 Operatori Ekonomik obligohet që pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ti përmbahet afatit të paraparë në planin dinamik të punës, projektin ideor, të përgatisë të gjithë infrastrukturën e nevojshme ligjore për fillimin e punimeve, duke siguruar shfrytëzimin apo destinimin e saj në të mirë dhe interes të përgjithshëm të qytetarëve.

Neni 12.

12.1 Kontestet eventuale lidhur me këtë kontratë, kontraktuesit do ti zgjidhin me mirëkuptim dhe marrëveshje. Në rast se palët nuk janë në gjendje që kontestin ta zgjidhin me mirëkuptim, atëher çfarëdo kontesti që ndërlihet me këtë kontratë do të zgjidhet duke i mundësuar palëve pa-anësim dhe bërëzi sipas ligjit në Gjykatën Kompetente.

Neni 13.

13.1 Kjo kontratë është përpiluar në katër (4) kopje identik dhe secila palë kontraktuese mbanë nga dy kopje, palët kontraktuese e kanë lexuar dhe kanë kuptuar përmbajtjen e kësaj kontrate, dhe në shenjë të pajtimit të vullnetit të tyre e nënshkruajnë pa vërejtje.

13.2 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrim nga ana e palëve kontraktuese.

Kryetari i Komunës së Kacanikut

z. Besim Ilazi



"KACINKA" L.L.C.





ZYRA E KRYETARIT

Nr. 104/02-5805/23
Datë 26.04.2023

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2, shkronja (d) dhe nenit 17, shkronja (c) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), si dhe të nenit 6 paragrafi 1, 2 dhe shkronja (h dhe q) të Statusit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statusit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të ligjit ligji nr. 06/1-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Neni 22, si dhe rregullore (qrk) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 27 pika 3, Kryetari i Komunës, me datën 26.04.2023 nxjerr këtë :

NJOFTIM

- I. Duke ju referuar Rekomandimit të komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik realizues 01.nr.104/02-31608/2022, të datës 29.11.2022, si dhe duke u bazuar në konstatimet e dhëna në Raportin e komisionit me nr. protokollit 01-04/02-7148/2023 të datës 21.03.2023, që në konkludimin e përgjithshëm ka konstatuar se investitori i ka përmbushur pjesërisht zotimet e lija sipas kontratës dhe detyrimet të tij për marrje në shfrytëzim afatgjata të parcelës komunale për zhvillim ekonomik.
Andaj kryetari në bazë të nenit 27 pika 3 ku thuhet Kryetari i komunës pas shqyrtimit të raportit merr masave përkatëse ndaj investitorit më qëllim të përmbushjes së kontratës, andaj në bazë të ligjit dhe rregullores kryetari nxjerr këtë njoftim.
- II. Njoftohet ofertuesi "KAÇINKA" L.L.C e regjistruar në zyrën e bizneseve në Kaçanik, me NRB. 81138429, me adresë në fsh. Kaçanik i Vjetër, Rruga Komandant Bardhi, pn, e përfaqësuar nga Jetmir Shebu, që në afat prej 3 muaj shtesë të bëjë realizimin e kontratës e cila kontratë është nënshkruar me datën 22 mars 2021, dhe në bazë të rekomandimit të cekur në konstatime duhet të përmbushen të gjitha pikat e cekura sipas kontratës , planit të biznesit , planit dinamik dhe numrit të punësuarëve , sipas afatit prej 3 muaj, nëse brenda 3 muajve nuk është bërë realizimi i kontratës dhe detyrimet e ti, kryetari do të veproj sipas ligjit dhe rregullores.

Sipas njoftimit të lartcekur, lidhur me shtyrjen shtesë të afatit prej 3 muaj propozohet si dispozitiv të këtij njoftimi.

Te bashkangjitur gjeni edhe raportin të komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut sipas planit dinamik.

Kryetari i Komunës
Besim Hazi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik / Municipality of Kačanik



Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Në mbështetje të Njoftimit 01Nr.104/02-9804/2023 të datës 26.04.2023 për shtyrjen shtesë të afatit prej 3 muaj që ka të bëjë me realizimin e kontratës dhe rekomandimit të cekur në raportin 01Nr.104/02-7148/2023, përpilon këtë:

RAPORT

Duke ju referuar Njoftimit 01Nr.104/02-9804/2023 të datës 26.04.2023 për shtyrjen shtesë të afatit prej 3 muaj që ka të bëjë me realizimin e kontratës dhe rekomandimit të cekur në raportin 01Nr.104/02-7148/2023 për ofertuesi "KAÇINKA" L.L.C e regjistruar në zyrën e bizneseve në Kaçanik, me NRB. 81138429, me adresë në fsh. Kaçanik i Vjetër, Rruga Komandant Bardhi, pn, e përfaqësuar nga Jctmir Shehu.

Gjatë inspektimit të punës është bërë kontrollimin sipas Njoftimit 104/02-9804/2023 të datës 26.04.2023 që ka të bëjë për shtyrjen shtesë të afatit prej 3 muaj për me realizimin e kontratës dhe rekomandimit të cekur në raportin 01Nr.104/02-7148/2023 për ofertuesin "KAÇINKA" L.L.C.

- I. Konstatohet se investitori nuk i ka përmbushur zotimet e tija sipas kontratës dhe detyrimet të tij për marrje në shfrytëzim afatgjat të parcelës komunale për zhvillim ekonomik dhe se i nijeti nuk ka bërë ndryshime lidhje me investime në objekt, dhe se gjendja është e njëjtë si në raportin 01Nr.104/02-7148/2023, të datës 21.03.2023.

Të bashkangjitur këtij Raporti janë edhe dokumentet si më poshtë:

- Fotot

Me këtë Raport njoftohen:

Kryetari i Komunës,

Kaçanik
Datë 18.10.2023

Zyrtari për çështje pronësore
z. Besmir Krasniqi



Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. "Qamil Ilaz" Nr. 28, Kaçanik 71000, Kosovë